

**KONSOLIDIMI I TE DREJTAVE TE PASURISE
NE SEKTORIN E RI TE FERMAVE PRIVATE
TE SHQIPERISE**

nga

**David Stanfield, Susana Lastarria-Cornhiel,
John Bruce, dhe Edward Friedman**

(Perkthyer nga Ilia Zhulati)

Ky projekt raport eshte pergatitur per USAID/Shqiperi sipas marreveshjes midis Universitetit te Wisconsin dhe Byrose se AID per Kerkime dhe Zhvillime. Raporti permban vezhgime paraprake te bera nga ana e nje grupi pune te Qendres se Ruajtjes Tokave te perbere nga John Bruce, Edward Friedman, Susana Lastarria, dhe David Stanfield.

Grupi ne fjale ishte ne Shqiperi per tre jave ne muajin Maj 1992 dhe deshiron te falenderoje personat e meposhtem per ndihmen e tyre te pakursyer: Stavro Mitezi, Komisioni Kombetar i Tokave; Ahmet Jazo, Drejtorja e Tokave; Lida Stamo, Nepunese per anen juridike; Zhana Kruja, Drejtoreshe per Punet e jashteme ne Ministrine e Bujqesise dhe asaj Ushqimore; Zef Preci dhe Ardiana Brahimi ne Institutin e Studimeve Ekonomike; John Pell i FAO-s; Romeo Sherko, Naim Sula, dhe Maksi Raco ne Degen e Informatikes te Universitetit te Tiranës; Lindita Lika dhe Sokol Dervishi (Interprete); dhe Diana Blane e USAID.

Te gjitha pikepamjet, interpretimet, rekomandimet, dhe konkluzionet e shprehura ne kete botim jane te autoreve dhe jo te organizatave te perkrahjes apo atyre bashkpunuese.

LTC Paper 146-A

Land Tenure Center

Universiteti Wisconsin-Madison

Dhjetor 1992

TABELA E CESHTJEVE KRYESORE

Page

Permbledhje	v
1. Hyrje	1
2. Origjina	2
3. Procesi i kolektivizimit	4
4. Baza juridike per reformen e privatizimit te tokes	7
5. Zbatimi I privatizimit te tokes per kooperativat	11
6. Kooperativat, shperndarja e tokes dhe gjinia	20
7. Te dhena rreth pasurise rurale	24
8. Pasuria urbane	27
9. Tokat pyjore	29
10. Tokat kullote	31
11. Prishja e fermave shteterore	34
12. Ceshtje qe kane lidhje me kredite	38
13. Perspektivat dhe rekomandimet	39
Perspektivat	39
Probleme dhe rekomandime	40
Nje rast i rendesishem: sistemi i regjistrimit te pasurise	42
Referenca	45
Anex: Ligjet shqiptare te tokes	47

PERMBLEDHJE

Reforma e kolektivizimit të kooperativave dhe fermave bujqesore ka qene dicka qe te len pershtypje te madhe si ne konceptimin e saj, ne kalimin radikal drejt pronesise se plote private, si dhe ne zbatimin e saj, e cila u be me nje shpejtesi shume te madhe. Ajo parashikon rritje ne prodhim per dy arsye kryesore: (1) nepermjet nje drejtimi me te mire te tokes nga ana e menaxherëve, me përgjegjësi të drejtpërdrejta per çfarë do të prodhoje toka dhe me dobi të drejtpërdrejta nga ai prodhim; dhe (2) duke siguruar te drejtat e pasurise per te stimuluar investime te reja per token dhe nje kujdesi me te mire te ketyre investimeve te bera. E para eshte perfunduar ne sektorin e kooperativave bujqesore, ndersa e dyta ngelet per t'u bere. Efektet e prodhimitarise nga keto ndryshime do te arrihen vetem ne rast se perdoren kanale me efektive dhe mjetet e nevojeshme, kredi dhe marketim, per sektorin e ri te pronareve te vegjel. Ristrukturimi i te drejtave te pasurise ne fermat shtetere, rajonet urbane, pyjet, dhe kullotat ka filluar dhe duhet te kete nje rendesi kryesore.

Ceshtjet e meposhteme jane disa prej vezhgimeve dhe analizave te bera nga ana e jone:

- Legjislacioni qe ben fjale per reformen e tokes eshte tranzistor deri sa Parlamenti te formuloje nje legjislacion real pasurie.
- Certifikata pronesie u jane dorezuar kryetareve te familjeve, te cilet jane pothuaj te gjithë burra. Edhe pse ligja nuk jep kufizime, grate ndodhen perballe praktikash tradicionale, te cilave i'u mohohet e drejta e pronesise.
- Reforma e tokes bujqesore ka qene pothuaj nje rishperndarje e tokes se kolektivizuar dhe organizuar ne kooperativa gjate viteve 50-te dhe 60-te. Nje pjese e tokes se fermave shtetere do te shperndahet, por shumica e tokes se fermave, kullotat dhe toka pyjore do te ngelen sic jane per kohen qe po flasim nen pronesine dhe drejtimin e shtetit.

- Edhe pse pronaret e rinj mund te japim toke me qira apo t'ia kalojne ate trashegimtareve te tyre, perseri e drejta per te blere e shitur token jane te kufizuara dhe ajo toke qe nuk eshte e perdorur per nje periudhe kohe nje vjecarwe, ajo duhet ti kaloje shtetit.
- Ligjet e tokes kerkojne qe toka e ish kooperativave te shperndahet midis familjeve te fshatrave mbi baza per fryme popullsie. Disa familje ne fshatra nuk jane dakord me nje rregullsi te tille dhe kerkojne qe shperndarja e tokes te behet mbi bazen e tokes qe zoteronte sejcila familje para kolektivizimit. Shperndarja e titujve te pasurise eshte zgjidhur nga ish pronaret per kerkesa te tilla, me ane te bisedimeve per ceshtjen e ndarjes se tokes se kooperativave midis fshatrave, dhe persa i perket dhenies toke te familjeve te migruara. Edhe pasi te jepet titulli juridik, perseri mund te linde nevoja te kerkohet te kalohet ne detyrime serioze juridike.
- Privatizimi i fermave shtetore, te cilat zene rreth $\frac{1}{4}$ e tokes se punueshme, nuk ka filluar akoma, edhe pse ekzistojne plane per shperndarje te rreth 50.000 ha te nje toke te tille ne te ardhmen per familje te ndryshme. Toka qe mund te mbetet nga shperndarja e tokes se fermave mund t'i kaloje investoreve te huaj si pjese e programeve te ndermarrjeve te perbashketa.

Qeveria eshte vene perballe disa vendimesh kritike ne keto disa muaj te kaluar, ku perfshihen:

1) Shperndarje e crregullt dhe sigurimi i tokes: Shperndarja e tokave te kooperativave nuk eshte bere gjithmone konforme strikt ligjeve te reja dhe rivleresimet e perseritura te vendimeve te tyre nga ana e komiteteve te tokave do ta demtoje sigurinë e zotërimit. Ne rekomandojme qe pas afersisht gjashte muajsh, te dale nje ligj per t'i dhene fund autoritetit te komisioneve te tokave; te siguroje qe pretendimet ndaj vendimeve te komisioneve te tokave, ne te ardhmen te trajtohen nga ana e gjykatave; te vendosë kritere për

gjykatat për të gjykuar këto pretendime dhe të japë udhëzimet për trajtimet e përshtatshme që duhen bërë dhe të kërkojë që të gjitha këto pretendime të paraqiten brenda një viti nga dalja e ligjit ose ndryshe të mbyllën si çështje.

2) Kompensimi: Vendimi i qeverisë për t'u marrë me pretendimet historike nëpërmjet kompensimit sesa me kthimin e tokës minimizon dislokimin e atyre që janë duke kultivuar. Kompensimi për pretendimet e tokës duhet të bazohet në pasuritë e para vitit 1945 dhe të zbatohen norma për shumfishim të caktuar të vlerës vjetore korrente të prodhimit. Kompensimi mund të jepet shumë mire në formën e kontratave për artikuj industriale të firmosura nga ana e qeverisë duke patur edhe interesat në ndermarrjet shtetërore industriale që janë privatizuar.

3) Tregjet e tokave: Edhe pse zhvillimi i tregjeve të tokës është i rëndësishëm për arritjen e përfitimeve maksimale nga një sistem i pasurisë private, në mënyrë të kuptueshme, qeveria i friksohet spekulimeve që mund të bëhen me tokën dhe ngeljes së familjeve të ndryshme pa tokë. Fillimisht, qeveria duhet të lehtësojë operacionin e një tregu rental, duke e drejtuar atë me kujdes dhe në një fazë të mëvonshme të bëhen shitje brenda fshatit. Më tej, pas pak vjetësh të kalohet në një treg tokë të pakufizuar në të gjithë vendin. Por, përderisa të mos ketë një strategji dhe baze juridike të mbrojtjes së interesave të familjeve në tokat private, nuk duhet lejuar bërja e shitjes së tokës. Kjo arrihet duke kërkuar që anëtarët e familjeve fshatare të bien dakort për çdo lloj shitjeje dhe që atyre t'ju jepet e drejta për një pjesë nga cmimi i shitjes. Me shumë rëndësi është edhe kodifikimi i të drejtave të barabarta të grave për blerje dhe shitje tokë.

4) E drejta e grave ndaj tokës dhe kredive: Edhe pse teorikisht gratë kanë të drejtën e përfitimit nga shpërndarja e tokës, në fakt, duket se shumë pak gra po marrin tokë. Kodifikimi i të drejtës së barabartë të gruas për të trashëguar, poseduar, shitur dhe blerë tokë është vecanërisht e rëndësishme dhe po ashtu edhe një program arsimimi në drejtim të burrave dhe grave lidhur me këto të drejta. Janë gjithashtu të nevojshme nënë që t'u

japet mundesi grave te marrin kredi ne emer te tyre dhe te sigurohet qe grate te mund prodhojne ne menyre efikase.

5) Pyjet dhe kullotat: Mbajtja e shumices se pyjeve dhe kullotave si toke shteterore ka nevojte per nene juridike per dhenien e rajoneve te pyjeve tek ndermarrjet private per prodhimtari te qendrueshme; dhenie me qira te rajoneve te nje shumellojshmerie speciesh dhe bimesh organizatave jo qeveritare per ruajtje, si dhe kalimin e rajoneve te pyjeve dhe kullotave nga nje pronesi shteterore ne pronesi te fshatrave lokale, ku nga ana e rajonit te ketyre fshatrave eshte pergatitur nje skeme e besueshme e drejtimit te pasurise së përbashkët për burimet.

6) Prishja e fermave shteterore: Rrethanat e ndryshme te fermave te ndryshme shteterore do te diktojne nje proces privatizimi krejt te ndryshem dhe per kete me sa duket do te duhen disa vjet. Megjithate, sido qe te jete mekanizmi, duhet kaluar ne shperndarje te fermave dhe privatizim te tyre. Privatizim nuk do te thote qe shteti te mos kete asnje interes si bashkëpronar ne ndermarrjet e privatizuara, por te jete nje bashkëpronar i vogel dhe pa ndonje rol te vecante drejtimi.

7) Ceshtje qe lidhen me kredite: Eshte e nje rendesie kritike qe Bankes se Bujqesise dhe Zhvillimit te mos i kerkohet te jape kredi per feramat shteterore, te cilat vazhdojne te humbasin te holla ne shuma alarmante. Subvencione te hapta dhe te singerta jane te preferueshme, ne kete apo ate rajon, qe Banka te mos humbase vlereshmerine dhe kredibilitetin duke kaluar ne huara qe nuk mund t'i mbuloje dot.

8) Sistemi i te dhenave te pasurise: Modeli i pronesise ndaj tokes eshte nje model i ri dhe transparent, me tituj te mbajtur nga gjenerata transaksionesh te prishura dhe trashegimnira ta paqarta. Kjo perben nje rast te vecante per krijimin e nje sistemi te regjistrimit te pasurise, nje hap ky i rendesishem ne arritjen e rezultatave te investimeve te pasurise private dhe te nje ndikimi efikas te reformes se tokes. Per nje gje te tille, nje hap i pare i rendesishem eshte

ngritja e nje Komisioni koordinues dhe e nje Komisioni Projektimi te nje sistemi per regjistrimin e te dhenave. Ky rajon i fundit, Sistemi i regjistrimit te pasurise, kerkon nje vemendje me te madhe se sa deri me tani. Ekzistojne nevoja te medha per asistencë teknike dhe te tjera ne kete rajon, dhe eshte me rendesi që programe të qeverisë dhe asistences te dhene nga jashte te perqendrohen ne nje drejtim te tille në të ardhmen e afërt.

1. HYRJE

Deri ne vitin 1976, shteti ishte pronar i gjithë pasurise se paluajtshme ne Shqiperi, pasi ishte perfunduar kolektivizimi i bujqesise dhe shpronësimi i pasurise se ngelur. Pas hyrjes ne ekonomine e tregut, prona private ka filluar te krijohet perseri ne nje shkalle masive.

Shqiperia ka filluar te ndertoje nje sistem te ri pronesie per token, i cili do te percaktoje ligjet e afrimit, perdorimit dhe pasurise se vertete te vendit te (patundshme), dmth, toka dhe burimet bashkengjitur tokes. Perdorimi i qendrueshem i burimeve me baze token kerkon krijimin e nje regjimi te ri ruajtje per te dhene qartesi dhe siguri te drejtave te pronareve te tokes dhe te siguroje se ekzistojne edhe tregues nxites per ta perdorur token ne menyre qe ajo te konservohet per gjeneratat e ardhshme. Vete toka kerkon investime afatgjata ne drejtimin e ruajtjes dhe rindertimit.

Per pasurine qe kane vete familjet duhen krijuar te drejtat ndaj pasurise per te siguruar ruajtjen e tokes, e cila ndihmon edhe per shfrytezimin e kujdesshem te burimeve per blegtorine. Toka do te pesoje ndryshime se do kaloje nga nje trashegimtar ne nje tjetër dhe me vone me te drejten qe ajo te shitet. Nevojitet nje sistem adekuat i te dhenave te drejtave per token, qe ajo te trashegohet gjenerate pas gjeneratash dhe te shitet si pjese e integruar e nje ekonomie te re tregu. Pyjet e vendit (qe aktualisht kapin mbi nje milione hektare), kullotat qe aktualisht kapin (mbi 425.000 ha), sistemi i ujitjes dhe ndertesat duhen vene nen nje sistem te ri decentralizimi te administrimit te tokes.

Ky raport mbikqyr ligjet dhe procedurat aktualisht ne fuqi dhe perparimin e bere ndaj reformes deri me sot. Ai ben edhe disa sugjerime lidhur me ceshtjet qe prekin politikanet shqiptare, por shqetesimi yne kryesor ka te beje qe te hidhet nje shikim me i larget, ne ate se c'fare i duhet Shqiperise per te dale nga kjo periudhe tranzitore dhe qe te ndertoje nje plan pasurie jetesor si pjese e nje ekonomie te re tregu. Ne njohim mundesite qe ka qeveria si dhe agjencite e tjera donore per te kontribuar ne kete proces.

2. ORIGJINA

Nje nga karakteristikat me te dukshme te politikës dhe zhvillimit bujqësor te Shqipërisë se pas luftës se dyte boterore ka qene kolektivizimi dhe perpjekjet e saj per vetsigurim te nevojave ushqimore. Para luftës se dyte boterore, rreth 25% e importit te pergjithshem e zinin prodhimet ushqimore (kryesisht gruri dhe misri), ndersa shperndarja e tokës as qe diskutohet. Politika e ndjekur nga shteti shqiptar pas luftës ka qene ajo e rritjes se sasise se tokës se puneshme, rritjes se prodhimit bujqësor, prodhimit te te lashtave per konsum kombetar si dhe rishperndarja dhe shoqërizimi i pasurisë tokësore.

Shqipëria perbehet nga tre rajone gjeografike dhe topografike: tokat fushore ne bregdetin mesdhetar; rajoni kondrinor, i cili permban rrafshina te gjera; rajoni i ftohte malor. Sipas statistikave te vitit 1989, toka e puneshme ne teresi ka qene 706 mije ha; kjo eshte dyfishuar ne krahasim me vitin 1950, ku toka e puneshme zinte rreth 390 mije ha. Pjesa me e madhe e tokës se puneshme eshte perfituar nga tharja e kenetave ne rajonin bregdetar dhe me zgjerimin e rrjetit vadites. Ndersa nje pjese tjeter toke u perfitua nga tarracimi i kodrave.

Ne vitin 1947-1948, shteti filloi nje sere projektesh thares dhe vadites ne rajonet e ulta fushore. Projekte te tilla u intesifikuan ne vitet 60-te dhe 70-te. Pervec zgjerimit te tokës se puneshme, prodhimi bujqësor u rrit edhe si rezultat i ndertimit te sistemeve vaditese. Ne vitin 1950 u vune nen uje rreth 39 ha toke, ndersa ne vitin 1960 u vu nen uje rreth 61% ose ne rreth (476 mije ha toke) (kjo sipas te te dhenave te UNDP dhe FAO-s, viti 1991, faqe 60).

Politika e zgjerimit te tokës se puneshme ka cuar ne lindjen e nje sere problemesh serioze erozionike dhe degradim te tokës, vecanrisht ne rajonet kodrinore dhe ato bregdetare. U kthyen shpesh kullota te tera ne toke bujqësore dhe po ashtu u prene edhe pyje per tu kthyer ne toka. Perdorimi i kullotave per kultivim nenkuptonte gjitheshtu prerjen e pyjeve per ti kthyer ne kullota. Nje pjese e kesaj toke te konvertuar duhet te kthehet ne toke pyjore dhe kullotore.

Pas luftës se dyte boterore, rreth 27% e tokës mbahej nga pronare, qe zinin 3% te numrit te pergjithshem te pronareve te

vendit, ndersa rreth 14% e familjeve fshatare nuk kishin aspak toke. Shumica dermuese e familjeve fshatare (83% e tyre) kishin secila mesatarisht 1,8 ha (sipas Sjöberg 1991, faqe 32-33). Gjate vitit 1945-1946 u kryen dy reforma agrare radikale. Pronaret e tokave u lejuan te mbanin vetem 5 ha toke te punueshme, ndersa ne me shume se 5 ha u jepej familjeve pa toke. Marre gjithë se bashku u rishperndane rreth 170 mije ha toke dhe i'u dha 70 mije familjeve te vogla fshatare pa toke.

Fermat shteterore te para u krijuan ne vitin 1945-1946 nga toka e cifligjeve¹ dhe nga fermat komerciale, prone e te huajve. Qiramarresit e ketyre fermave u kthyen ne punetore te fermave shteterore. Edhe kooperativat e para u krijuan ne keto vite, ndersa kolektivizimi u krye me vone dhe kapi nje periudhe kohe te gjate.

Para reformave te vitit 1991, kooperativat bujqesore zinin rreth 5.000 km² toke, ndersa fermat shteterore mbajne akoma 1.600 km² toke. Ka gjithashtu 10.400 km² te zene nga pyje dhe 4.240 km² te zene nga kullota. I gjithë territori i Shqiperise eshte hedhur ne harta topografike te shkalles 1:25.000, ndersa nje pjese toke gjate bregdetit eshte hedhur ne harta topografike te shkalles 1:10.000. Hartat e parcelimit te fermave shteterore dhe ish kooperativave jane te shkalles 1:5.000. Rajoni i pergjithshem i vendit kap 28.748 km², me nje popullsi rreth 3,26 milione banore dhe nje prodhimi te pergjithshem te brendshem per fryme te popullsisë llogaritur ne US dollar-600 ne vitin 1990. Sektori bujqesor eshte i rendesishem, i cili kap rreth 33% te prodhimit neto materilal te vendit dhe angazhon nje force punetore rreth 50% te numrit te pergjithshem te popullates te zene me pune te vendit (Blejri et al. 1992, faqe 2).

3. PROCESI I KOLEKTIVIZIMIT

¹Sistemi i cifligjeve ishte nje dicka e mbetur nga periudhe e sundimit otoman te Shqiperise. Sipas ligjeve te ruajtjes se tokes ne kete periudhe, fshataret ishin te detyruar te shisnin krahun e punes tek cifligaret, shteti dhe institucionet fetare. Ne Shqiperi, cifligjet zinin sidomos tokat bregdetare, tokat kodrinore deri ne bregdet, si dhe rrafshinen e Maliqit ne pjesen juglindore te vendit (Sjöberg 1991, faqe 29).

Procesi i kolektivizimit u be duke duke grumbulluar tokat e mbajtesve te saj dhe duke krijuar kooperativat bujqesore per te prodhuar kolektivisht. Nje proces i tille zgjati per me shume se 20 vjet. Kooperativa e pare bujqesore u krijua ne vitin 1946 ne zonat bregdetare. Gjate fazes se pare te kolektivizimit, toka e fshatareve per te formuar kooperativat bujqesore u be mbi baza vullnetare. Familjet fshatare grumbulluan pjese te tokave te tyre per t'i punuar kolektivisht dhe mbajten rreth 0,25 ha per ta punuar ne menyre individuale. Shteti i inkurajoi fshataret qe te hynin ne kooperativa duke ju dhene nje trajtim te preferuar, si zvogelimi i taksave dhe kuota me te ulta ne dorezimin e detyrueshem te prodhimeve te ndryshme. Nga fundi i vitit 1954, u formuan rreth 150 kooperativa, te cilat perfshine rreth 8.900 familje fshatare me me shume se 31.500 ha toke (Sjöberg 1991, faqe 88).

Po gjate kesaj periudhe filloi edhe kolektivizimi i gjese se gjalle. Pas vitit 1948, familjet fshatare nuk mund te mbanin me shume se 50 koke bageti, dele dhe dhi, ndersa ato qe kishin me shume se kaq ju konfiskoheshin, nga qe ishin kafshe pune. Disa fshatare i theren bagetite e tyre vetem qe ato te mos konfiskoheshin.

Faza e dyte e kolektivizimit filloi aty nga mesi i vitit 1950 dhe kishte si objektive qe te zgjeronte prodhimin bujqesor ne tere rajonet kodrinore dhe bregdetare si dhe ne rajonet malore jugore dhe te fillohej me kolektivizimin e pjeses tjeter te vendit (pjeses veriore dhe rajonit malor qendror). Ne vitin 1959 ishin krijuar me shume se sa 1.800 kooperativa, te cilat perfshinin 114.700 familje dhe mbulonin rreth 290.000 ha toke (Sjöberg 1991, faqe 88). Fshataret u inkurajuan qe te dorezonin pjesen me te madhe te tokes se tyre dhe gjese se gjalle ne kooperativa dhe te pakesonin numrin e gjese se gjalle dhe sasine e tokes qe e kishin prone vetiake. Megjithate, familjet fshatare munden te mbanin 0,25 ha toke deri pas vitit 1964.

Nje zhvillim tjeter gjate fazes se dyte te kolektivizimit kish te bente me konsolidimin e kooperativave. Pas vitit 1959, shume kooperativa u bashkuan per te formuar kooperativa me te medha. Pra, edhe pse sasia e tokes se kolektivizuar filloi te rritej, numri i kooperativave filloi te ulej dhe kaloi nga 1.829, viti 1959, ne 421, viti 1983.

Viti 1965, faza e trete finale e kolektivizimit. Pikesynimet e kesaj faze ishin qe te behej kolektivizimi i plote i atyre rajoneve te vendit ku kolektivizimi kishte filluar ne fazen e

mepareshme, shkaterrimi i plote i prones private dhe rritja e tokes se punueshme. Nga fundi i vitit 1967 u realizua kolektivizimi ne rajonin malor dhe familjet fshatare nuk mund te mbanin me shume se 0,11 ha toke (Sjöberg 1991, faqe 88). Po ashtu u zvogelua ne maksimum edhe numri i bagetive qe duheshin per nje familje fshatare. Pra, me nje fjale, kolektivizimi u inkurajua apo u detyrua (sipas pikepamjes se ndonjerit) nepermjet zvogelimit te taksave, jo interes kredit per kooperativat, rritja e cmimeve per dorezimin e detyrueshem te prodhimeve bujqesore, zhvillimi ne rritje infrastrukturor, shperndarja e mjeteve te tilla te nevojeshme si (plehrave kimike, farerave te permiresuara, insekticideve) dhe sherbimeve (psh, stacioneve te makinave dhe traktoreve) ne kooperativat e rajoneve malore.

Konsolidimi i kooperativave u be pasi ato u bashkuan ne kooperativa me te medha, nganjehere ato zinin fshatra te tera. Ndersa ne vitin 1959, siperfaqja mesatare e kooperativave ishte 175 ha, ne vitin 1983 arriti ne 1.320 ha. Gjate kesaj kohe, pervec zvogelimit te oborrit privat familjar ne me shume se gjysmen e tij, shteti detyroi me force edhe kolektivizimin e plote te gjese se gjalle te mbajtuar nga familjet fshatare dhe mbylli tregjet private qe kooperativat i perdornin per te shitur prodhimet e tyre shtese. Kjo ishte edhe faza perfundimtare qe i vuri vulen nacionalizimit te tokes ne tere vendin. Kushtetuta e vitit 1976 deklaroi se e gjithë toka ishte prone e shtetit.

KUTIA NR. 1

Kooperativa ne fshatin Cerence te rrethit te Dibres, ne rajonin verior malor te vendit, u krijua se pari ne vitin 1958 dhe perfshinte vetem dy fshatra. Ne ate kohe, familjet fshatare ishin te lejuara te mbanin per vete nje hapsire rreth 1 ha toke. Kur u intesifikua kolektivizimi, fshatrat u bashkuan se bashku per te formuar kooperativa me te medha, ndersa prona personale u zvogelua, fillimisht ne 1,5 dynym dhe me vone ne 1 dynym. Ne vitin 1962, me fshatin cerence u bashkuan edhe dy fshatra te tjere per te formuar nje kooperativeve me te madhe. Terreni i thyer nuk u kolektivizua deri ne vitin 1967.

Gjate periudhes se fillimit te kolektivizimit, familjet ishin te lejuara te mbanin edhe gje te gjalle. Por me intesifikimin e kolektivizimit u pakesua edhe numri i bagetive per familjet fshatare. Gjeja e gjalle e kooperativave qendronte ne kullota te marra qira nga fermat shteterore. Praktikisht, ne vitin 1983 u kolektivizua edhe gjeja e gjalle duke u krijuar stalla me te medha, dhe si rezultat numri i gjedheve filloi te pakesohet.

Puna ne kooperativa ishte e organizuar me brigada. Nje pjese e prod-himit mbahej nga ana e kooperatives per anetaret e saj. Por, kooperativa duhej ti kthente kuota te caktuara edhe shtetit, edhe ne rast se nevojat e saj nuk ishin te plotesuara. Anetaret e kooperatives paguheshin gjate vitit mbi bazen e dites se punes se bere. Ne fund te vitit bujqesor, prodhimi i pergjithshem i kooperatives llogaritej ne valute. Ne rast se rezultonte mbivlere pas mbulimit te shpenzimeve, mbivlera ju paguhej anetareve te kooperatives. Brigadat e dalluara merrnin edhe shperblim ne fund te vitit. Prodhimi ne kooperative financohej nepermjet kreditit te shtetit, i cili shpesh nuk ripaguhej plotesish.

Gjate vitit 1970, pasi kishte perfunduar plotesisht koolektivizimi, politika bujqesore u perqendrua ne bara zimin e te ardhurave te produkteve bujqesore ne rajone te ndryshme, si dhe ne permiresimin e kushteve jetesore ne rajonet rurale. Keshtu, filloi procesi i elektrifikimit ne te gjithe vendin, ku rajonet malore moren edhe sherbime te proferuara bujqesore dhe perfitime sigurimesh shoqerore (sigurimin shendetesor dhe pensionet). Sherbime te tilla u shtrine deri tek familjet fshatare (nga qe nepunesit e ndermarrjeve shteterore, perfshi edhe fermat shteterore, i gezonin aktualisht keto perfitime). Kooperativat bujqesore ishin i vetmi mjet ku ushqeheshin familjet e zonave rurale, ndersa fermat shteterore kishin si detyre te benin furnizimin e qyteteve. Nepunesit e fermave shtetore rrogetare gezonin privilegje edhe ne sektorin rural.

Gjate viteve 80-te, keto perpjekje u neutralizuan pjeserisht, kur politika u perqendrua ne rritjen e prodhimit bujqesor nepermjet koncentrimin te investimeve dhe mjeteve te nevojeshme ne shumicen e rajoneve prodhuese te vendit, vecanrisht ne rrafshinat bregdetare dhe ato ne brendesi te vendit. Qellimi i politikes se vetsigurimit te ushqimeve, vecanerisht te drithrave te bukes dhe prodhimeve blegtorale vazhdoi te sherbente si politike e drejtimit bujqesor. Masat intesifikuese ne fushen e bujqesise perfshine edhe mjetet per rritjen e prodhimit te plehrave kimike dhe mekanizmave zgjedhese ne rajone te caktuara. Ndersa zonat malore u inkurajuan per t'u specializuar ne prodhime blegtorale (si ne mish dhe prodhime qumshti), ato shpresoheshin qe te ishin edhe vetsiguruese ne prodhime per buken e perditeshme.

Edhe ne fund te viteve 80-te, politika bujqesore ndryshoi dhe perparesi ju dha prodhimit, i cili duhej te behej me eficient.

Ne vitin 1988, shteti lejoi hapjen e tregut privat per shitjen e shumices se prodhimeve bujqesore. Oborret private familjare filluan qe te njiheshin nga ana e shtetit dhe u vleresuan si njesi kryesore prodhimi. Oborri privat u lejua te rritej ne masen deri 0,2 ha dhe kooperativat bujqesore filluan te rindanin baqeti per familjet fshatare.

4. BAZA LIGJORE PER REFORMEN E PRIVATIZIMIT TE TOKES

Para reformes se karakterit juridik te vitit 1991, pasuria private ne tokat bujqesore, nga ana juridike, ishte e pamundur sepse sipas kushtetutes se vitit 1976, e gjithë toka i perkiste shtetit. Baza juridike e privatizimit te tokes gjen konkretizim ne ligjin Nr. 7491, date 29 prill 1991, "Mbi dispozitat baze te kushtetutes", dhe ne vecanti kapitulli 10-16. Kjo perben edhe autoritetin cituar ne dekretimet kryesore mbi rishperndarjen e tokes (ligji Nr. 7501, date 19 korrik 1991) dhe pasuria private (ligji Nr. 7512, date 10 gusht 1991). Tre dekretimet kryesore jepen ne retrospektive, ndersa te tjeret jepen shkurtimisht. Gjithcka ligjore qe jepet ketu me poshte eshte e perkthyer ne gjuhen angleze dhe i eshte aneksuar ketij raporti. Ketu po japim mendime te dala nga vzhgimet dhe analizat e bera nga ana e jone:

Ligji Nr. 7512 (date 10 gusht 1991) titullohet: "Mbi sanksionimin dhe mbrojtjen e pasurise private, iniciatives se lire te aktiviteteve te pavarura private dhe privatizimit". Tashma, bujqesia konsiderohet nje sektor i ekonomise qe duhet ti nenshtrohet privatizimit; pyjet dhe burimet ujore do te ngelen aktivite te shtetit me perjashtim te rasteve te vecanta te siguruar nga ligji (seksioni 3). Ne rajonet ku shteti vazhdon te operoje akoma, eshte shume e mundur qe te krijohen ndermarrje te perbashketa me kapitalin e huaj (seksioni 4). Personat lokale juridike kane te drejte te kene prone te tyre token ku ndodhen ndertesat. Toka dhe ndertesat mund te merren prej shtetit kundrejt pageses. Nje toke e tille mund te blihet dhe shitet, por jo nga te huajt, te cilet kane te drejte ta marrin me qira per nje periudhe kohe prej 49 vjetesh. Kur nje ndermarrje apo biznes i shitet nje te huaji, i huaji fiton te drejten e pronesise mbi biznesin dhe ndertesën, ndersa per token, te drejten e marrjes me qira (seksioni 21).

Ligji Nr. 7501 (date 19 korrik 1991) titullohet: "Ligji mbi token". Ai e ndan te gjithë token ne tre kategori: (1) toke bujqesore (perfshi ketu vreshtat), kudo qe te ndodhen ne tokat rurale dhe urbane; (2) toka e zene nga pyjet, kullotat dhe livadhet; dhe (3) toka e zene nga ndertesat, toka per perdorim publik (parqe, rruge etj), rajone shkembore, plazhe, dhe rruge ujore. Shteti ka te drejten e nderrimit te pronesise private te tokes, por nuk e ka te drejten e shitjes dhe blerjes (seksioni 2) dhe ve nje gjobe nga 2.000 deri 5.000 lek² ne rast se behen transferime jo ligjore (seksioni 23). Kjo ndoshta nuk i takon tokes me ndertesa qe behen fjale ne ligjin 7512. Me baze ligjore duket edhe marrja me qira e tokes bujqesore, megjithese kjo nuk eshte ende e specifikuar. Toka bujqesore duhet tu jepet per pronesim personave juridike dhe falas. Familjet qe kane qene pjese e kooperativave bujqesore kane te drejte qe te marrin toke dhe mund te terhiqen nga nje gje e tille. Pjesa e tokes qe u takon ketyre personave duhet percaktuar nga komisioni i ndarjes se tokes me ndihmen e komisioneve te ndarjes se tokes se rajoneve (seksioni 5, 7). Zyra e mbikqyrjes se tokave ne Komitetin Ekzekutiv te Keshillit Popullor te rajonit eshte pergjegjese per mbajtjen e cdo te dhene per nje gje te tille (seksioni 9). Pervec anetareve te kooperatives, toke mund t'ju jepet edhe personave te tjere bazuar ne udhezimet e Keshillit te Ministrave (seksioni 6). Po ashtu, bazuar ne udhezimet e Keshillit te Ministrave, te huajt kane te drejten e marrjes se tokes me qira per te bere ndertime (seksioni 4).

Udhezime me te detajuara jepen ne vendmin Nr. 255 te Keshillit te Ministrave, date 8 gusht 1991, lidhur me shperndarjen e tokes dhe vreshtave. Kur nje kooperative eshte e perbere nga disa fshatra, toka duhet shperndare, se pari, midis fshatareve, bazuar ne siperfaqen e tokes qe ka vete fshati (seksioni 1). Toka duhet ndare mbi baza te drejta ne cdo fshat sipas anetareve te cdo familje perjashto ketu ata qe punojne ne punera shteterore dhe private, te cilet kane te drejten e marrjes se gjysmes se pjeses se personave te tjere, apo deri ne 1/10 ha (seksioni 2). Banoret rurale, te cilet nuk jane anetare te kooperatives kane te drejten e marrjes se gjysmes se pjeses qe kane te drejte te marrin anetaret e kooperativave, ose deri 4/10 ha per person, por nuk e kane te drejten e marrjes se pronesise mbi token, apo qe t'ja u shesin personave te tjere (seksioni 3). Toka bujqesore brenda kufijeve te verdhe te fshatit nuk duhet dhene per pronesim, por perkohesisht duhet kaluar ne ruajtje nga Komiteti Ekzekutiv i Keshillit Popullor te fshatit (seksioni 4). Qe

²_90 lek = US\$1.00.

gjithcka te shkoje ne rregull, vendimi ben fjale edhe per formulen e konversionit per lloje dhe cilesira te ndryshme te tokes, per toke nen uje e jo nen uje (seksioni 5), per toke kodrinore (seksioni 6), dhe per toke te permiresuar (sic mund te thuhet per token e tarracuar) sipas sistemit qe perfshin klasen nga 1-10 (seksioni 7). Vreshtat duhen ndare si cdo lloj tjetere toke, perfshi edhe pemet (seksioni 8), ndersa ata qe marrin serat duhet te paguajne per to (seksioni 9).

Pervec sa siper ekzistojne edhe nje numer vendimesh te rendesishme:

Vendimi Nr. 230, date 23 korrik 1991, qe ben fjale per ngritjen e komisioneve te tokave, ata te rajonit dhe te fshatrave, perfshi edhe proceduren e zgjedhjeve te ketyre komisioneve.

Neni Nr. 2, date 2 gusht 1991, i cili ben fjale per funksionimin e Komisioneve te Tokave te Komiteteve Ekzekutive te rajoneve dhe fshatrave, jep udhezime per perberjen e anetareve te ketyre komisioneve, te drejtat e komisioneve te rajoneve, te cilet mbajne pergjegjesi per percaktimin e kufijve te tokes se puneshme te kooperativave per shperndarje, dhe japin udhezime te hollesishme mbi procesin e ndarjes se tokes midis familjeve te cdo fshati nga ana e komiteteve te fshatrave.

Vendimi Nr. 256, date 2 gusht 1991, i cili ben fjale mbi rregullat e regjistrimit, ndryshimeve dhe transferimeve te tokes shteterore ne toke private dhe ndryshime qe duhen bere ne kadastra: jep funksionet e zyrave te kadastrave ne reformat, per rishikimin e te dhenave qe flasin per perdorimin e tokes dhe per rregullat e kalimit te tokes per kompetence te komitetit ekzekutiv te rajonit. Shumica e neneve kanë të bëjnë me mbajtjen e te dhenave te ndryshme mbi token dhe thekson gjithashtu se paaftesia per ta perdorur token per nje vit ben qe ajo ti kthehet fshatit per rivleresim (seksioni 16) dhe se mbajtesit e rinj te tokave mund ta nderrojne token per konsolidimin e pozitive te tyre (seksioni 17).

Vendimi Nr. 266, date 8 gusht 1991, i cili ben fjale per shperndarjen e pasurise se kooperativave bujqesore, te dhena per mbylljet financiare te kooperativave, perfshi ketu edhe pagesat e borxheve

dhe ndarjen e burimeve dhe vlerave te tundshme, perfshi ketu edhe gjedhet midis anetareve te kooperativave.

Vendimi Nr. 307, date 29 gusht 1991, i cili ben fjale per detyrat dhe te drejtat e Agjencise Kombetare mbi Privatizimin dhe Komisionet Pergatitore te Procesit te Privatizimit; te dhena mbi institucionet e nivelit kombetar bashkengjitur Minsitrise se Ekonomise, e cila eshte ngarkuar te ndjeke qellimet e privatizimit te pasurise shteterore dhe marredheniet e tyre me njesite e privatizimit brenda ministrive te vecanta.

Vendimi NR. 387, date 11 tetor 1991, i cili ben fjale per administrimin e kanaleve ujore te fshatrave nga ana e Ndermarrjeve te Sistemit te Ekonomise Komunale dhe ben te qarte se keto ndermarrje shteterore ruajne autoritetin qe te mbajne dhe drejtojne keto adekuate (kanale ujore) dhe te ngarkojne fshatrat te paguajne per ujin qe ato perdorin.

Kjo perben nje pune te shkelqyer nga ana juridike per nje periudhe nje vjecare. Ligjet u pergatiten ne menyre urgjente, ne nje ambjent politik qe ndryshonte ne menyre te shpejte dhe ne nje fare menyre shume prej ketyre ligjeve jane pak skicore dhe rudimentare. Ajo qe te ben me shume pershtypje eshte se reforma u ndoq nga ana e vet qeverise me nje shqetesim te dukshem per sa i perket drejtesise dhe kembenguljes.

Procesi i kolektivizimit dhe shperndarjes se tokes i ngjan pak a shume modelit te reformes kineze ne vitet pas vitit 1978, por me gjithte ate bien ne sy disa ndryshime rrenjesore midis te dy paleve. Ajo c'ka po ndahet dhe sa i takon per fryme cdo individi ne Shqiperi i ngjan asaj qe u be ne fshatin kinez. Ndarja e tokes ne disa kategori para shperndarjes midis fshatareve krijoi pengesa te ngjashme fragmentare. Shume fshatra kineze erdhen ne nje model te tille duke ndjekur nje rruge ndryshimesh dhe eksperimentimi ne rritje. Fillimisht, atje nuk pati udhezime te qarta nga ana e shtetit kinez. Me vone, u bene hapa te ndryshme dhe qeveria urdheroi ne menyre urgjente komunat qe te vepronin sipas udhezimeve te dhena nga ana e saj. Ndersa ne Shqiperi, shteti, qysh prej fillimit, impomoi nje plan te detajuar per shperndarjen e tokes dhe qe nje plan i tille te zbatohet juridikisht. Dhe, natyrisht, Shqiperia hyri ne menyre te drejtperdrejt ne privatizim te plote, ndersa ne Kine toka vazhdon te zoterohet

nga fshatrat dhe u eshte dhene fshatareve me nje afat shume te gjate.

Venia e theksit per zbatimin e rregullave te qarta ne reformen e Shqiperise flet per premtime dhe per nje angazhim ne rrugen e zbatimit te drejtesise dhe ligjit. Nga ana tjeter, kjo ka edhe te keqen e vet. Shperndarja e tokes ne nje numer te shumte fshatrash eshte bere jo konforme rregullave ne fuqi. Disa prej aresyeve te devijimit do te shqyrtohen kur te bejme shikimin e zbatimit te ligjeve. Rruget e afrimit alternative per shperndarjen e tokes mund te jene pelqyer nga shumica, por jo ne menyre anononime nga komunat. Ne disa komuna mund te kete edhe kundeshitime per ceshtjen e shperndarjes se tokes dhe qe mund te kerkojne me force rishperndarje te tokes, kunder vullnetit te shumices se popullsisë. Kjo perben nje perspektive te mbushur me dilema politike per qeverine dhe nuk duhen marre lehte. Mund te jete e nevojeshme te dilet me ligje per t'u marre me kundershitime te tilla.

Numri i ligjeve te nxjerra per tokete fshatit, por qe ajo toke te mos njihet nga shteti per shkak te taksave qe jepen sipas siperfaqes se secilit. Sidoqofte, nga qe shume tituj per perdorim te perkohshem u jane dhene edhe shume banoreve të përhershëm per lloj toke te degraduar, nuk eshte akoma e qarte se si duhen trajtuar tituj te tille nga ana e komunave lokale. A do te jene tituj te tille te trashegueshem? A do te jene tituj te tille te kalueshem nga nje person tek tjetri dhe po qe se po kush do ta kete te drejten e dhenies se aprovimit, Komiteti i fshatit apo i rajonit? A mundet që, mbajtes te tille titujsh ti konsiderojne ato te nje sigurie te mjaftueshme per te motivuar investime qe mund te behen per te permiresuar token e degraduar, nepermjet pyllezinit, apo zhvillimit te nje sistem prodhimi agropyllzues, terracimit, apo ujitjes?

Banoret e perkohshem ne fshat, si mesuesit, tekniket, etj, kane te drejten e marrjes per perdorim te tokes per kohen qe do te jene ne fshat. Qellimi ka te beje me ate qe te ndihmohen keshillat e fshatrave qe toka te tilla t'ja u caktojne personave te tjere, sapo pronaret aktuale te vdesin, apo kur ata mund te largohen prej fshatit.

Qysh prej muajt 31 tetor 1992, 406.651 ha (87% e ish tokes se kooperativave, nga 70% qe ishte ne muajin maj 1992) u eshte shperndare 296.261 familjeve (shiko tabelen 1). Megjithate, statistikat MBU ne tabelen 1 lidhur me shtrirjen e shperndarjes se tokes vjen prej KSTR, sipas te cilit toka

duhet te shperndahet menjehere sapo KNTF te kete perfunduar procesin e allokimit, dhe nuk pasqyron plotesimin perfundimtar te certifikatave (tapive) zyrtare te allokimit. Plotesimi i certifikatave eshte vonuar dhe rreth 37% e familjeve kane mundur te pajisen me certifikata allokimi. Ne tabelen Nr. 1, ne mund te shohim se ekzistojne ndryshime midis 36 rretheve, nga ku kater rrethe kane mundur te shperndajne vetem 2/3 e ish tokes kooperativiste (Diber, Lac, Malesi e Madhe dhe Mat, te gjithe ne pjesen veriore te vendit) dhe po ashtu ekzistojne edhe diferenca midis rretheve ne shperndarjen e certifikatave te allokimit (shiko fig. 1 per kufijte aktuale te 36 rretheve, nga 26 qe ishin ne vitin 1991).

Problemi qe po haset per shperndarjen e tokes se kooperativave ka te beje me nje sere aresyesh. Problemi kyc eshte se familjet fshatare kerkojne qe t'ju jepet toka e tyre e mepareshme. Per shumicen e fshatareve duket se kjo deshire nuk ka te beje thjesht me sasine e tokes se dhene ne krahasim me ate te mepareshmen. Ne fakt, shume prej familjeve kane marre shume here me shume toke per fryme se sa kane patur me pare. Dhe kjo ka ndodhur se shumica e familjeve kane patur shume pak toke me pare dhe se toka e punueshme eshte zgjeruar nepermjet projekteve te bonifikimit dhe vaditjes. Megjithate, familjet deshirojne te kthehen tek ajo cope toke qe familja e tyre ka patur me pare dhe, kjo jo vetem per shkak te lidhjes me token, por ne disa raste ajo mund te pasqyroje edhe nje fare ndjenje se cilesia e tokes qe kane patur me pare eshte shume me e larte (shiko kutine Nr. 3 per ndonje shembull tipik).

Ky problem i vecante duket teper serioz ne rajonin e veriut, dhe kjo me teper per shkak te traditave dhe se ne kete zone kolektivizimi nuk ka shume kohe qe ka perfunduar ne krahasim me pjeset e tjera te vendit dhe se ne kete pjese te vendit familjet kane me shume tradita. Kodi i Lek Dukagjinit (Gjecov 1989), i pergatitur shekullin e kaluar, por qe qendron ende i gjalle edhe sot, flet per pikepamjen tradicionale te pronesise qe duhet te kete akoma nje fare baze ne kulturen shqiptare, vecanerisht per popullaten e pjeses veriore te Shqiperise. Ne rrethin verior te Lezhes, per shembull, ne faqen (70-72), Kodi thekson:

FIGURA 1
Harta e administrates
se re te Shqiperise
(1992)

Toka, e cila ka pase qene perdorur per kopesht ose fushe apo vend banimi, edhe po te jete lene e djerre per 100 vjet, nuk duhet te zihet ose perdoret nga kerkush tjetër ne fshat.

Per njerez me besime te tilla, kerkesat per rimarrjen e tokes se tyre te mepareshme mund te jete shume e forte.

KUTIA NR. 3

Para kolektivizimit, fshati jugor i Ravonikut ne rrethin e Korces nuk kishte toke nen uje, dhe edhe sasia e tokes se punueshme ishte e paket. Gjate ketyre dekadave te fundit, sasia e tokes se punueshme eshte rritur per shkak te projekteve te tharjes dhe vaditjes. Sot, ky fshat ka rreth 350 ha toke te punueshme dhe e gjitha nen uje. Prodhimet kryesore jane gruri, misri, fasulet, panxhar sheqeri, dhe foragjeret.

Fshati i Ravonikut ka thithur popullate edhe prej vendeve per rreth Korces. Nje migrim i tille e rriti popullaten e ketij fshati nga 10-15 familje ne vitet 40-te ne 160 (perafersisht ne 600) banore sot, qe banojne ne fshat. Edhe pse familjet e vjetra bene perpjekje per njohje te drejtave te tyre te mepareshme, komisioni beri te qarte se nga shperndarja e tokes do te perfitojne te gjitha familjet qe ndodhen ne fshat sot. Komisioni i shperndarjes se tokes llogarit se ndodhen vetem tre familje qe kane humbur toke ne krahasim me c'ka ato zoteronin para koolektivizimit. Shumica e familjeve perfituan toke prej shperndarjes sepse toka e punueshme ne fshat ishte rritur si siperfaqe nepermjet projekteve te bonifikimit.

Disa fshatra kane devijuar nga rruga qe duhet ndjekur per shperndarjen e tokes per fryme te popullsisë qe jeton ne fshat. Shume komuniste insistojne qe toka te ndahet sipas reformave te bera ne vitin 1946, qe "toka ti jepet atij qe e punon". Kjo behet, me teper, per kunder kundertimeve te ish pronareve te tokave ose trashegimtareve te tyre, te cilet kerkojne kthimin e tokes qe ata kane patur para vitit 1946. Keta as qe mund te konsiderohen latifondiste, por ajo qe mund te jete prekur nga kolektivizimi mund te kete qene nga 10 deri ne 20 ha dhe se ish pronare te tille tokash nuk jane banues ne fshat sepse kanë lëvizur në qytete apo jashtë vendit, në përgjithësi nuk kanë patur mundësi të bejne presion në mënyrë efektive per nje problem te tille. Ata apo trashëgimtarët e tyre vazhdojne, megjithate, te kerkojne nga qeveria qe t'ju kthehet toka ose të paktën t'ju paguhet kompensim per token qe u eshte marre.

Nje problem i ngjashem ka te beje me qendrimet ndaj familjeve te migruara. Ne keto pese dekada te kaluara, familje nga zonat malore kane migruar ne zonat fushore dhe rrafshinat. Shume prej tyre kane gjetur pune ne feramat shteterore, ose ne kooperativat e bashkuara. Tani qe toka e kooperativave eshte shperndare, ata qe u vendosen ne fshat dhe u futen ne kooperative kane te drejte te marrin toke si edhe familjet e tjera te kooperatives. Kjo ka shkaktuar probleme ne disa zona sidomos per banoret e hershem te fshatit, sidomos ne ato fshatra qe kane thithur familje te shumta nga zonat malore. (Kutia 3 dhe 4 flet per nje problem te tille ne dy fshatra te ndryshme.)

KUTIA NR. 4

Problemi kryesor ne shperndarjen e tokes qe po haset ne fshatin Cerence ne rrethin e Dibres, ka te beje me ate se shume fshatare kerkojne tokat e tyre te mepareshme. Ata nuk jane dakord me nenet e ligjit mbi token dhe qe toka te ndahet per cdo familje sipas frymeve te tyre. Disa familje nuk deshirojne gjithashtu te marrin toke qe i perket dikujt tjetri.

Nje problem tjetër i madh ka te beje me familjet e reja ne fshat. Ne Cerence dhe ne fshatra te tjere te ndodhur ne fund te luginave, banojne aktualisht familje te tera te zbritura nga zonat malore te vendit. Familjet e vjetra te fshatit nuk deshirojne qe toka te shperndahet proporcionalisht edhe per familje te tilla.

Nje problem tjetër ka te beje me ate te kufijve te fshatrave. Kur u konsoliduan kooperativat ne vitet 60-te dhe 70-te, shume fshatra u bashkuan per te formuar kooperative te medha. Ne vitin 1991, toka i kaloi perseri atyre fshatrave para bashkimit ne kooperative te medha. Historikisht, fshatra te ndryshme, kane patur baze burimesh te ndryshme. Ligji i tokes ben fjale qe Komisioni i shperndarjes se tokes ne rrethe te mund qe te pershtase ata kufij ne menyre qe sasia e tokes e gatshme per fryme ne cdo fshat te jete e njejte. Kjo procedure, apo mos ndjekja e saj disa here, ka shkaktuar probleme midis fshatrave ne disa raste.

Nje problem tjetër ka te beje me qendrimin ndaj famijeve te migruara dhe kufijve midis fshatrave, gje kjo qe e ka vonuar perfundimin e tapive te tokave. Komisioni i shperndarjes se tokave ne rrethe nuk jep aprovim per perfundim te ketyre certifikatave ne rast se ne fshatra nuk bihet dakort me nenet e parashikuara ne ligjin e tokes. Fillo nga 31 tetori i vitit

1992, rreth 18 muaj pas fillimit te shperndarjes se tokave, eshte shperndare pothuaj rreth 87% e tokes, por jane vetem 37% e familjeve qe jane pajisur me certifikata (shiko tabelen 1).

Kur te regjistrohen te drejtat e pronareve te tokave, keto probleme mund te sherbejne si baze e forte per pretendime ndaj te drejtave te pronareve te rinj. Pra, eshte me shume rendesi qe probleme te tilla te kuptohen dhe te rregullohen para se te behet regjistrimi zyrtar dhe te caktohen edhe kritere te drejta per zgjidhjen e kerkesave te tilla. Ne rekomandojme qe keto kritere te percaktohen dhe te sherbejne si udhezime per personat qe gezojne autoritetin e berjes se regjistrimeve per te regjistruar te drejtat sipas shperndarjes se tokes si dhe per te zgjidhur crregullime teknike gjate procesit te shperndarjes se tokes. Kur mund te ndodhe nje crregullim, zgjidhja e preferuar do te jete qe te kompensohet pala e demtuar e te mos kalohet ne krijim shqetesimesh lidhur me ceshtjen se c'ka i takon nje pale te caktuar. Shoqeria ka interes te madh ne krijimin e nje fryme besimi ne aftesine e saj per te siguruar sigurine e ruajtjes se tokes.

6. KOOPERATIVAT, SHPERNDARJA E TOKES DHE GJINIA

Ndersa grate ne rajonet rurale kane punuar direkt ne prodhimin e produkteve bujqesore per nevojat e tyre, nen sistemin e kooperativave bujqesore, ato u angazhuan akoma me shume ne pune bujqesore. Ne bujqesi ekzistonte nje ndarje tradicionale e puneve. Burrat merreshin me punimin e tokes dhe prerjen e druve, ndersa grate merreshin me mbjelljen e bimeve, korrjen e te lashtave, heqjen e bimeve te demshme nga te mbjellat e tyre. Mekanizimi i bujqesise ne keto kater dekadat e shkuara e ka lehtesuar si punen e grave dhe ate te burrave, por grate bejne akoma pune te renda bujqesore. Makinerite drejtohen kryesisht nga burrat.

Pjesmarrja e grave ne pune bujqesore ne kooperativa eshte rritur keto vitet e shkuara per shume arsye. Si rezultat i perparimit te kolektivizimit, u zhduken edhe burimet e pavarura te te ardhurave dhe kooperativat u bene burimi kryesor i te te ardhurave te tyre. Nje tjetër arsye ishte edhe largimi i burrave nga fshati per te gjetur punera me te mira ne qytete, apo ne feramat shteterore. Pra, per rrjedhim, grate perbenin forcën kryesore prodhuese ne bujqesi. Nga 41% pjesmarrje te tyre ne bujqesi ne vitin 1961, ne vitin 1981 perqindja shkoi ne 52,4% (Sjöberg 1991, faqe 117). Ne disa rajone, pjesmarrja e grave ishte me shume se 70%. Edhe nga nje shikim ne vitin 1992 vihet re se perseri grate perbejne forcën kryesore te puneve bujqesore. (Kutia Nr. 5 ilustron pjesmarrjen ne vazhdim te grave ne prodhimin bujqesor.)

KUTIA NR. 5

Fshati Turan ne rrethin jugor te Korces ka kaluar veshtiresira ne marrjen e konsensusit te nje plani shperndarjeje te tokes. Qe nga muaji Maj 1992, shumica e tokes te ish-kooperatives nuk ka qene shperndare apo te jete kultuar. Kur ekzistonte kooperativa, ne kooperative punonin si burrat dhe grate. Grate benin shumicen e puneve bujqesore ne fushe si prashitjen, coptimin e dheut me shata, etj. Ato punonin gjithashtu edhe ne stalla duke treguar kujdes per kafshet. Tashma, ndersa fshatari mund te diskutoje rreth menyres se shperndarjes se tokes, grate kane shkuar ne ferma dhe kane filluar nga puna. Shumica e grave te intervistuar ne fshatin Turan benin pune te pjeseshme ne ferma duke mjelur lopet, ose benin punera te tjera ne qytet. Pervec

kesaj, jane grate ato qe punojne ne kopshtin e shtepise per te siguruar ushqim per familjet e tyre.

Ne kooperativa buqesore, si burrat dhe grate merrnin te njejten page. Duhet thene se nuk paguhej koha e punes, por puna e perfunduar e tokes qe kultivohej. Ndersa ne fillim te kolektivizimit, te gjitha te ardhurat i paguheshin kryetarit te familjes, ne vitin 1967 kjo politike ndryshoi dhe secili e merrte pagen vecmas.

Ne keto dekadat e fundit, ne kooperativa u bene perpjekje per lehtesimin e punes se grave duke hapur lavanteri, kopshte femijesh, cerdhesh, furra buke dhe menxa kooperativash buqesore. Te tilla gjera u pranuan me lehtesi ne pjesen jugore te Shqiperise, ndersa ne pjesen me veriore te vendit, sherbime te tilla te brendshme nuk u pranuan. Kjo, sigurisht, varet nga vlerat kulturore te rajoneve te ndryshme. Nga ana e familjeve ne veri ndjehej se mosberja e puneve te tilla nga vete familjet perbente nje gje te turpshme.

Prishja e kooperativave dhe shperndarja e tokes mund te influencoje direkt edhe per grate. Se pari, do te pushoje shumica e sherbimeve qe jepeshin nga ana e kooperativave dhe kjo do te rrise punet shtepiake per grate dhe mund te pengoje anen e arsimimit per grate e reja. Se dyti, nga qe si burrat dhe grate vazhdojne te punojne ne bujqesi, burrit ose kryetarit mashkull do ti duhet te tregetoje prodhimet dhe te marre te ardhura nga kooperativa. Se si eshte caktuar kjo midis anetareve te familjes dhe kush do te vendose se si duhet harxhuar kjo e ardhur, do te percaktoje edhe efektin e privatizimit per grate. Duhet theksuar se familjet shqiptare, vecanerisht ato ne rajonet rurale, tradicionalisht dominohen nga mashkulli. Deri nga fundi i viteve te 30-te, shumica e shqiptareve bashkejetonin ne familje te medha te kryesuara nga mashkulli me i moshuar (Hasluck 1933). Te gjitha marredheniet percaktoheshin nga burrat; grate bashkoheshin me familjen e burrit vetem ne martesese. Sot, njesia familjare e zgjeruar eshte jo e zakonshme, por dominimi i familjes nga mashkulli qendron ende si ligj dhe eshte akoma e orientuar nga mashkulli.

Nje ceshtje tjeter qe lind nga problemi i shperndarjes se tokes se kooperatives dhe qe do te jete baras e rendesishme kur shperndahen edhe vlere te tjera, si banesa, prodhime nga kooperativa, etj. ka te beje me faktin se kush e gezon te drejten e titullit per token. Edhe pse shumica e tokes qe do te shperndahet varet nga numri i anetareve te cdo familjeje, te gjitha jane dakord qe grate kryetare familjeje (d.m.th,

grate e ve) duhet te marrin toke ne emer te tyre. Nga nje shikim i shpejte i listave te fshatit, shume rralle grate kane marre toke. Edhe pse numri i grave te ve ne nje fshat nuk eshte i vogel, perseri ato qe kane marre toke perbejne nje numer minimal.

Duke i hedhur nje shikim dokumentacionit te nje fshati, ne vume re se nga 146 familje, vetem tre gra ishin titullare te tokes. Edhe pse sasia e tokes ne ate fshat ishte rreth 21.000 m², sasia e tokes dhene grave ishte nga 9.000 deri 16.000 m², duke sugjeruar se keto jane familje shume te vogla. (Kutia Nr. 6 jep nje shembull tjetër te praktikës se ndjekur për shpërndarjen e tokës në sasi të vogla të barabarta për grate).

KUTIA NR. 6

Ne fshatin Ravonik te Korces vetem pese gra nga 160 familje qe ka fshati moren toke si kryetare familjeje. Kur anetaret e komisionit te shperndarjes se tokes u pyeten ne se grave u takonte te merrnin toke si edhe burrat, ata u pergjegjen se nga ana juridike grate nuk kishin asnje kufizim per marrje toke. Duke kerkuar te dinim per keto pese gra qe moren toke, morem vesh se ato nuk kishin mashkull tjetër ne shtëpi, as burre dhe as mashkull tjetër. Pra, keto pese gra jane te ve dhe jetojne vetem, me nje nga vajzat e rritura ne moshe, ose me femije te vegjel.

Pra ku eshte e drejta e trashëgimise për grate dhe ata qe mund te trashëgojne toke prej tyre? Me e rendesishmja, a mund te shitet toka pa pelqimin e tyre? Ekzistojne precedente te shumte prej vendeve te tjera te angazhuara ne individualizimin e te drejtave te tokes se bashkeshorteve, te cilet kerkojne punesim jashte sektorit te bujqesise dhe bejne shitjen e tokes se familjeve te tyre duke i lene ato te varfera. Ky problem teper serioz duhet trajtuar drejtperdrejt dhe ne menyre te qarte kur te lejohet tregetimi i tokes, apo edhe para saj. Ligjet e firmosur ne vitin 1991 tregojne vetem sasine e tokes dhene nje familjeje dhe qe duhet caktuar sipas personave qe ka cdo familje. Po ashtu, ligja kerkon aprovim prej pronarit para kalimit te tokes tek shteti ose tek pronare te tjere si mjet shkembimi. Sidoqofte, kjo nuk tregon nese "pronari" eshte kryetar i nje familjeje ose anetareve te nje familjeje te llogaritur per percaktimin e sasise se parceses se tokes.

Sipas sistemit tradicional te pasurise, pasuria toke (pra, toka, shtepia, pasuria) i takonin djemeve te shtepise. Vajzat merrnin vetem paje ne kohen e marteses se tyre (rroba, te holla, dhe artikuj shtepijake), por nuk kishin te drejte te trashegonin pasuri toke, vetem ne raste shume te rralla (vetem ne raste kur nuk kishte meshkuj ngelur gjalle ne ate familje dhe kur gruaja nuk ishte e martuar) (Durham 1928). Ligji i ri modern shqiptar thekson se te gjitha femijet e nje shtepie kane te drejta te barabarta. Megjithate, ne fshatra, ne pjesen veriore te vendit, vazhdon te veproje akoma forca e ligjeve tradicionale. Pjesa fushore e vendit dhe ajo jugore mund te jene me perparimtare ne kete drejtim, pra lidhur me te drejatat ndaj pasurise nga grate, por te dhenat nuk jane te mjaftueshme per te bere nje percaktim me te sakte. Po ashtu edhe vete fakti se kohet e fundit nuk ka ekzistuar prone private mbi token, eshte veshtire te predikosh se c'ka do te ndodhe per ceshtjen e trashegimnise. Nga ana e parlamentit po merret ne shqyrtim nje ligj i ri qe ka te beje me trashegimnise, i cili mund te kete influencen e tij ne kete ceshtje.

Situata e grave lidhur me trashegimnise eshte nje problem i veshtire qe komplikohet nga pozita tradicionale e vete atyre dhe familjes se burrave te tyre. Traditat shqiptare e trajtonin token si nje familje se sa nje pasuri individuale (Whitaker 1976). Duke qene se grate shpresonin te martoheshin dhe te linin familjen e tyre, nuk ekzistonte as interesi qe atyre t'ju njihej e drejta e pasurise per token e babait. Nga ana tjeter, grate ndesheshin me probleme te shumta ne familjen e burrit nga ana e te afermeve te tij (Whitaker 1981). Kjo komplikohet edhe nga fakti se grate shqiptare kishin te drejten e mbajtjes se lidhjeve me familjen e tyre, sidomos me vellezrit e tyre, te cilet mbanin pergjegjesi per mbrojtjen e tyre dhe ruanin te drejten e pajisjes se tyre me nje shtepi ne rast se ajo nuk keqtrajtohej prej burrit, apo familjes se tij, dhe kur ajo ngelej e ve. Pra ekzistonte nje interes shume i vogel per kalimin e pasurise tek grate e martuara nga qe ajo konsiderohej si e huaj dhe po te trashegonte toke, kjo mund ti humbiste familjes (Shryock 1988).

Eshte e paqarte se sa shume do te vazhdoje nje gjendje e tille ne Shqiperine paskomuniste. Ka nje numer artikujsh dhe libra qe flasin per vlerat tradicionale dhe statusin e grave ne Shqiperi vecanerisht per epoken para komuniste (Durham 1928; Wochick dhe Meyer 1985; Pipa 1985; Biberaj 1990; Whitaker 1976; Shryock 1988). Ajo qe nuk eshte e dokumentuar eshte statusi i grave qysh prej kohes se demokratizimit dhe privatizimit dhe efekteve te ketyre proceseve ndaj tyre. Psh,

nuk eshte e qarte se c'ka mund te perfitojne grate qe divorcohen; divorci eshte nje fenomen i rralle ne Shqiperi (Uçi 1973). Nen regjimin komunist kishte pak pasuri per tu ndare dhe qendrimi i qeverise se re eshte i pasigurte. Qendrimet e shoqerise ndaj grave dhe si e konsiderojne vete grate veten e te drejtat e tyre, kjo duhet studjuar.

7. TE DHENA RRETH PASURISE RURALE

Asnje sistem pasurie nuk mund te funksionoje ne menyre efektive si pjese e nje ekonomie tregu, pa nje sistem te pershtatshem te te dhenave te pasurise. Te drejtat per token kane nevojte te levizin nga nje gjenerate ne tjetren dhe po ashtu edhe midis bleresve dhe shitesve te tokes. Sa me i madh dhe sa me privat te behet tregu, aq me te medha do te jene edhe nevojat per nje sistem regjistrimi per te provuar titujt dhe shmangjen e rreziqeve ne transaksionet. Rreziqet e medha dhe shpenzime te tjera per transaksione qe lidhen me veshtiresine e proves per ceshtjen e titullimit e ulin ne maksimum eficiencen e tregut te tokes dhe po ashtu edhe tregues te tjere nxites te investimeve te shoqeruara me pronen private.

Shitja e tokes nuk ka marre akoma aprovim juridik, ndersa trashegimnia, dhenia me qira dhe shkembime te tjera jane te lejuara. Trashegimnia ka krijuar probleme imediate per t'u zgjidhur. Mundet qe ne te ardhmen djali apo vajza te kthehen me siguri ne deshmitare ndaj fjaleve te babait, kur ai te konfirmoje ceshtjen e dhenies se asaj cope toke trashegimni. Por kur ai apo ajo deshirojne ta perdorin token e marre trashegimni si garanci per nje hua, trashegimtari duhet te jete ne gjendje qe ta dokumentoje vlefshmerine e asaj toke te marre trashegimni, d.m.th, nese babai ishte apo jo pronar i asaj toke, nese kalimi i saj u be fakt i kryer dhe c'fare toke mori ne te vertete femija e tij si trashegimni. E dhena e nevojshme sigurohet vetem kur te jepet nje testament ne forme te shkruar ligjore, kur ai testament te jete kthyer ne nje ceshtje te nje te dhene publike autoritare.

Nevoja te tilla behen akoma me akute per pjesmarresit e reformes se tokes. Ne nje ekonomi te ekonomise se tregut moderne, sigurimi i vlefshmerise dhe saktesise se informacionit te pasurise per nje sere formash te ruajtjes se tokes perben nje problem kritik per personat e angazhuar ne

ekonomine e vertete te pasurise. Shteti siguron mjete nga ku ata qe jane te angazhuar ne ekonomine e tregut duhet te jene te sigurte se cilat te drejta dhe te verteta jane te ekzagjeruara. Nje siguri e tille ka rendesi te madhe si per personin e brendshem ashtu edhe per investitorin e huaj. Kur shteti krijon sistemin e tij te regjistrimit te tokes, ai krijon keshtu edhe infrastrukturen publike per nje ekonomi tregu toke.

Te dhenat jane fare te pakta per ata qe kane qene pronare tokash para luftes se dyte boterore, te cilat perbeheshin vetem prej kontratash dhe dokumentesh, qe jane ne duar te pasardhesve te tyre. Te dhena pak a shume te plota krijoi rishperndarja e tokes qe u be ne vitin 1945 dhe 1946, ne reformen e tokes. Pra, u krijuan lista te personave kryefamiljare qe fituan te drejten e marrjes se tokes, sasine e tokes se marre si dhe vendin se ku e moren. Edhe pse nje dokumentacion i tille ekziston ne shume rajone, ne rrethet e tjera nje dokumentacion i tille u demtua pjeserisht apo teresisht gjate periudhes se kolektivizimit.

Gjate periudhes se viteve 1967-1991, Instituti per pune kerkimore shkencore mbi tokën ne Tirane ne bashkepunim me të 26 rrethet e vendit dhe zyrat perkatese te kadastrave ka ruajtur nje kadastrim fizik te te gjitha parcelave te tokave ish prone e kooperativave dhe fermave shteterore. Kjo kadaster permban edhe harta te ndryshme te paracelave te tokave te nje shkalle 1:5.000, ku jepen te dhena rreth sasise dhe kapacitetit kryesor te cdo parcele.

Keto harta parcelash jane nxjere prej fotografive te ndryshme ajrore te nje shkalle 1:10.000, dhe jane prodhuar duke perdorur teknika vezhgimi te tokes nga ana e zyrave te kadastrave dhe Institutit per pune kerkimore shkencore per token ne Tirane. Fotografimi rajonal eshte siguruar nga ana e Institutit ushtarak te topografise ne Tirane, i cili eshte i vetmi qe ka te drejten ekskluzive te prodhimit te hartave rajonale te topografise se vendit. Ky institut prodhon gjithashtu edhe harta topografike per te gjithë vendin te nje shkalle 1:50.000 dhe me te vogla. Baza teknologjike qe perdor ky institut i perket vitit 1970 dhe duke qene keshtu nuk ka mundesi te prodhoje harta te nje shkalle me te madhe se sa 1:10.000.

Programi i shperndarjes se tokave perfshin te dhena te niveleve te ndryshme. KNTF kalkulon shtrirjen per fryme ne cdo lloj toke dhe numrin e pergjithshem te popullsisë se fshatrave. Mandej, KNTF merret me pergatitjen e planit per

shperndarje. Ata pergatitin harta skice te cdo lloj parcele caktuar per familje, perfshi ketu edhe emrat e pronareve te tokave fqinje, formen qe ka pak a shume cdo parcele, dimensionet e kufijve dhe rajonin e parcelave. Per cdo familje pergatitet edhe nje certifikate provizore, ku rregjistrohen parcelat e ndryshme dhene cdo familjeje, rajonin e parcelave, llojin e cdo toke si dhe token ne teresi shperndare fshatareve.

Mandej informacioni rreth tokes se shperndare i kalon zyres qe merret me pergatitjen e tapive nen mbikqyrjen e zyrave te kadastrave te rrethit dhe nen kontrollin e Ministrise se Bujqesise dhe asaj Ushqimore. Keto certifikata qe i takojne pronareve te tyre qe e kane marre token per perdorim te perkohshem firmosen nga cdo anetar familjeje duke bere te ditur edhe token e shperndare, lista e cdo parcele te caktuar, perdorimi i saj kryesor, rajoni i saj dhe emri i pronareve fqinje te pasurise ose disa tipare fizike te kufirit (si psh te nje rruge, etj). Nje kopje e kesaj certifikate mbahet nga zyra e kadastrës se rrethit, ndersa kopja origjinale e firmosur nga pronari i tokes, nga kryetari i KNTF dhe ai i KSTR mbahet po nga marresi i tokes.

Informacioni i zyres se kadastrës dhe dokumentacioni i shperndarjes se tokes ne cdo rajon eshte teper i detajuar, ne disa raste edhe niveli i organizimit dhe eficiencia eshte e shkelqyer. Per cdo fshat, ne zyren e rrethit, mbahet edhe ky lloj informacioni. Per disa rrethe si ai i Kavajes dhe ne cdo fshat informacioni gjendet po ne zyren e rrethit, ndersa me rrethe te tjere, informacioni nuk eshte i sakte.

- (1) Nje liste permbledhese e te gjitha familjeve qe kane marre toke me emrat e kryetareve te familjes dhe sasine e tokes se marre prej tyre per perdorim te perkohshem.
- (2) Harta e kadastrës se fshatit (keto jane harta kolektive te fushave te kooperativave ku jane hedhur te gjitha parcelat e shperndara.
- (3) Format e fushes (te firmosura nga ana e cdo kryetar familjeje dhe zyrtareve qe u moren me shperndarjen e tokes), lista e cdo familjeje qe ka marre toke bashke me shtrirjen e kufijve te tokes dhe nje skice per cdo parcele. Informacioni ne kete formular eshte perdorur per te plotesuar te dhenat qe kerkohen per tapite.

- (4) Nje liste e familjeve qe moren toke si pasuri, duke specifikuar edhe parcelat qe ato moren.
- (5) Nje liste e familjeve qe moren toke per perdorim jo të përhershëm duke specifikuar edhe parcelat qe ato moren.
- (6) Nje liber ku te perfshihen te dhena per te gjitha parcelat sipas llojit dhe kategorise se tyre me kalkulime per standartizimin e rajoneve te tokes.

Qellimi i zyrave te kadastrave te rretheve eshte qe te pergatisin harta te detajuara te regjistrimit te tokes bazuar ne kufijte midis parcelave te percaktuara nga KNTF (zakonisht gure dhe post monumente). Nje perpjekje e tille ka filluar ne shumicen e rretheve edhe pse hartat e detajuara ne pak fshatra jane te perfunduara. Nje perpjekje e tille nuk ka filluar ne shumicen e rretheve edhe pse hartat e detajuara per disa fshatra jane te perfunduara.

Midis blloqeve te banesave te fshatit dhe per rreth tyre gjenden toka bujqesore krijuar nga ish kooperativat bujqesore, toke prone e pronareve te tjere.

- _ Toke e perdorur per banesa dhe perdorim per qellime urbane.
- _ Fermat shteterore, ne shumicen e rasteve, perbehen prej toke te perfituar si rezultat i tharjes se kenetave dhe toka te perfituara prej ish cifligjeve. Ne disa raste, toka e fermave shteterore perfshin toka ish prone e fshatareve, apo edhe toke e thithur prej ketyre fermave nga toka e kooperativave bujqesore fqinje, ose nga qe ferma shtetërore mund te jete krijuar si rezultat i bashkimit te disa kooperativave.
- _ Tokat kullote jane prone e shtetit dhe kane qene te drejtuara drejtperdrejt nga ana e Ndermarrjeve shteterore nepermjet perfaqesuesve te ndermarrjeve ne Komitetetet Ekzekutive te 27 rretheve te vendit. Sot po diskutohet qe toka te tilla ti kalojne keshillave te fshatrave. Afatet e kalimit te tyre nuk jane percaktuar ende, por mund qe kjo toke te kaloje ne perdorim te fshatit, ose ne pronesi te plote po te fshatit.

- Edhe tokat pyjore jane ende prone e shtetit dhe drejtohen nga Drejtoria e pyjeve nepermjet perfeqesuesish me te 27 rrethet e vendit.

8. PASURIA URBANE

Ne rajonet urbane (rajonet e perdorur per shtepi banimi ne ish kooperativat, ne qytezat dhe qytetet, si dhe ato per industri, sherbime, etj.), ndertimi dhe mbajtja e banesave ka qene koordinuar nga keshillat e fshatrave (me konkretisht nga keshillat e kooperativave, pas vitit 1971) si dhe nga keshillat e qytezave e qyteteve ne bashkepunim me Institutet urbanistike te 26 rretheve te vendit. Keto institute urbanistike posedojne harta zonash per te drejtuar procesin e aprovimit te ndertimit te banesave si dhe perdorimit te tokes urbane dhe asaj per qellime industriale brenda kufijve te rajoneve te urbanizuara (brenda "vijes se verdhe") per secilin rreth.

Nen regjimin e meparshem, ne rruge te ndryshme, ndertimi i banesave private nuk inkurajohej, fillo me kohen qe kerkohej qe nga momenti i aprovimit ose zgjerimit te nje ndertese (psh, per Korcen kjo kapte kohen nga 2-4 vjet) deri ne konfiskimin e nje banese private per aresye te ndryshme duke dhene pak ose aspak kompensim per nje gje te tille. Njerzit qe mbanin ndertesen e konfiskuar ne menyre te tille ishine te detyruar t'i paguanin shtetit qira me te drejten e mbajtjes se baneses per nje kohe te gjate.

Shumica e banesave urbane ka qene e administruar nga Ndermarrja Komunale e Banesave ne secilin prej rretheve administrative dhe i kerkonte qiramarresit deri 30 lek ne muaj per nje apartament dy dhomash, ose 35 lek per nje apartament pak me te madh. Deri ne vitin 1991, te drejtat private per shtepi banimi kane qene te kufizuara sidomos lidhur me te drejten e kalimit te baneses si trashegim per banesat e ndertuara privatisht ose nga shteti. Pas vendimeve te marra ne vitin 1990 dhe 1991, njerëzit jane marre ne menyra te ndryshme me token, perfshi ketu blerjen e tokes prej shtetit per ndertimin e banesave, shitjen e tokes midis paleve private, si dhe te drejten e trashegimise. Po ashtu jane percaktuar rregulloret e dhenies se lejeve te qirave me afat

te gjate midis shtetit dhe personave private per pasurira per qellime komerciale ne qendrat e qyteteve.

Ne rajonet urbane, transaksione te tilla jane te dokumentuara, fillo me testamentet per trashegimimi dhe aktet e shitjes (keto te fundit duhej te aprovoheshin nga keshillat lokale), te pergatitura prej avokateve, noteruar prej Noterive te rretheve (nje zyrtari te gjykates se rrethit te emeruar nga Ministria e Drejtesise) dhe arkivuar ne Zyren e Hipotekes se rrethit. Zyrrat e Hipotekave dokumentojne origjinalin e dokumenteve (nje kopje ruhet ne Noteri). Ne disa juridiksione, zyra e Hipotekes leshon certifikata per pronaret duke bere fjale edhe per te drejttat qe ata kane per parcela te vecanta tokash te indetifikuara me adresen e rruges e te pershkruara nga nje plan studimi. Ne rrethe te tjera, si psh, per Tiranen, zyra e Hipotekes dokumenton akte me emrat e paleve ne nje kolone, ben nje permbledhje per transaksionin ne nje liber regjistrimi dhe vulos aktet per te indetifikuar te dhenat e tyre, por nuk leshon certifikata te vecanta pronesisie per pronaret e rinj.

Ky sistem operon vetem per pasurite urbane. Transaksionete tilla ishin teper te kufizuara ne regjimin e kaluar, por jane shtuar gjate vitit te shkuar. Per shembull, ne vitin 1989, ne rrethin e Korces me perafersisht 11.500 banesa, 600 ishin te regjistruara si transaksione te tokes urbane per gjithe vitin. Gjate pese muajve te pare te vitit 1992, 820 kane qene te noteruaradhe regjistruara si transaksione, qe mbi bazavjetore do te thote nje transaksion per cdo gjashte banesa. Ne Lushnje ka patur vetem 40 transaksione ne kater muajt e pare te vitit 1992 (me nje popullsi ne me pak se sa 5.000 banore). Ne Tirane, zyra e Hipotekes u rihap me 19 mars 1991 pas nje peidudhe mbylljeje prej 10 vitesh. Gjate pese muajve te pare te vitit 1992, ka patur 1.809 transaksione te regjistruara, c'ka do te thote nje transaksion per cdo 11 banesa ne 12 muajt e vitit 1992.

Pas vitit 1944, shteti mori te drejten e pronesisie per cdo lloj industrie ne rajonet urbane dhe konfiskoi pasurite e familjeve te angazhuara ne tregeti duke i cilesuar edhe si armiq te shtetit. Shumica e ketyre konfiskimeve u bene pa asnje lloj kompensimi, ose me nje kompensim shume te vogel, nje pagese simbolike. Mbyllja e gjithe tregjeve private ne 1983 perfundoi procesin e venies se ekonomise nen kontrollin e shtetit. Ne qytetin e Korces, zyrtaret vleresojne se 6-10% te familjeve te tanishme banuese vuajten nga nje lloj i tille konfiskimi, por kjo shifer mund te jete me e larte. Shumica e dyqaneve te konfiskuar jane ende te boshatusur, ndersa ne

raste te tjera, gjate ketyre dy vjeteve te shkuara, hapsira per dyqane u jane dhene me qira tregetareve. Ne disa raste, ndertesat e konfiskuara jane prishur dhe ne vend te tyre jane ndertuar banesa banimi ose zyresh. Me rikrijimin e ekonomise se tregut, kerkohen rregulla per rihapjen e bizneseve private dhe ricaktimi i hapsirave per personat qe merren me biznes privat.

9. TOKAT PYJORE

Rajoni i pergjithshem pyjor i Shqiperise mbulohet nga 1.044.680 ha, me nje volum te pergjithshem 82,1 milione m³, 50,4 milione m³ prej te cileve zihen prej lende druri. Pyjet percaktohen, te pakten, si rajone nga ku 30% mbulohen prej pemesh ose kacubesh. Aktualisht, te gjitha pyjet jane prone e shtetit nen drejtimin e Ndermarrjes se Pergjithshme te pyjeve te Ministrise se Bujqesise dhe asaj Ushqimore. Rajoni i pyjeve eshte ulur ne keto 40 vjet te shkuara, ne rreth 280.000 ha te humbur edhe pse ne vitet 1980, rajoni pyjor eshte rritur ne rreth 30.000 ha per shkak te pyllzimit te tokes ledhore (zakonisht asaj kullotore) dhe uljes se kthimit te te pyjeve ne toke bujqesore.

Po ashtu brenda pergjegjesive te Drejtorise se pyjeve eshte edhe drejtimi i rajoneve nen mbrojtje. Pavarsisht nga humbjet e rajoneve pyjore dhe mocaleve qe i jane dhene tokave te bukes dhe humbjeve te tjera te tokes gjate dekadave te shkuara, ne Shqiperi ka akoma rajone te paprekura nga dora e njeriut. Biologet vleresojne se ne vend ka akoma te pakten 3.200 specie bimore. Gryket e gjera te lumenjve dhe kenetat e detit bashke me tokat e laguara prej bregdetit te Adriatikut jane akoma vende te rendesishme per qendrimin e shume zogjeve dhe llojeve te tjera te kafsheve si vende shumezimi ose ushqimi gjate migrimit. Rajonet me te rendesishme jane ato ne Kune ne Lezhe, ato te izoluara ne keneten e Karavastase-Divjake, si dhe kodrat ranore afer Lushnjes, te cilat kane qene pjeserisht te mbrojtura. Pyjet e paperdorur ne malet e larta jane rajone te rendesishme per kafshet e egra dhe burimet gjenetike per gjitha kontinentin evropian. Megjithate, te dhenat lidhur me llojshmerine e specieve jane te pakta. Per kete kerkohet nje inventarizim me i mire i specieve per te vleresuar plotesisht shumellojshmerine qe ekziston akoma.

Parqet kombetare zene pergjithesisht 9.340 ha dhe rezervuaret e gjuetise vetem rreth 35.000 ha, kryesisht gjate bregdetit te

Adriatikut. Duket qarte se mbrojtja efektive e rajoneve te shumellojshmerise biologjike nuk eshte e plote. Per kete kerkohen perpjekje te menjehereshme per zgjerimin e rajoneve pyjore dhe per modifikimin e perdorimit te atyre pyjeve si dhe parqeve kombetare dhe rajoneve te tjera te pambrojtura. Nje ndalim e mbrojtje e tille nuk do te thote mohim i plote i forcave te ekonomise se tregut. Psh, Ekoturizmi ne keto rajone, mund te kerkoje shkembime te rendesishme me vendet e tjera.

Tani po vleresohet legjislacioni i ri per nje drejtim te permiresuar te pyjeve dhe industrive, te cilat merren me perpunimin e prodhimeve pyjore. Eshte me rendesi te behen rregullime te reja per angazhimin e njerezve neper rrethe ne drejtimin e pyjeve , keshtu qe do te kete nje angazhim te dyanshem per rigjenerimin e pyjeve te prere dhe kontrollin e vendqendrimit te kafsheve per inkurajimin e procesit natyral te rigjenerimit. Me uljen e legjitimitetit dhe pushtetit te shtetit ne kuadrin e nje krize ekonomike akute, njerëzit e fshatrave neper rrethe mund te ndjehen te motivuar per te marre c'ka te munden nga ajo qe eshte konsideruar prone shteterore dhe te mos shqetesohen per implikimet ekologjike dhe ekonomike afatgjata te grabitjeve te ndryshme.

Duhen vene ne prove opsione te reja juridike, politike, organizuese dhe me konkretisht:

- _ Pronesim të pemeve si prodhime ekonomike nga ana e individeve private per inkurajimin e mbjelljes se pemeve pavarsisht nga statusi i mbrojtjes se tokes ne bashkepunim me entitetin qe njeh pronesine ndaj tokes.
- _ Pronesim (ose dhenie me qira per nje kohe te gjate) te tokave pyjore nga ana e keshillave te fshatrave ose shoqatave jo qeveritare te rretheve dhe fshatrave bashke me perpjekjet per te gjetur opsione te qendrueshme nga pikepamja ekonomike per nxjerrje prodhimesh stabel pyjore prej ketyre rajoneve.
- _ Pronesim ose marrje me qira per nje kohe te gjate nga organizatat jo qeveritare dhe pronaret e ndryshem te rajoneve te nje biodiversiteti te rendesishem, i cili mund te ruhet dhe marketohet per programe ekoturistike.

- Ndarje e prere dhe inventarizim i rajoneve delikate te nje diversiteti te madh biologjik ose qe jane ne rrezik te zhdukjes se specieve.

Per drejtimin e ketyre formave te shumellojta te zotërimit të tokes, te nje rendesie fundamentale jane hedhja ne harte e parcelave pyjore dhe ndarja e kufijve te tyre ne toke.

10. TOKAT KULLOTE

Rajonet e kullotave, te cilat perbehen prej pjerresirash te dukeshme me bimësi natyrale, qysh prej vitit 1946 kane qene gjithashtu prone shteterore. Para vitit 1980, shteti jepte me qira kullota tek pronaret e kafsheve te imta, por me kolektivizimin e ketyre kafsheve pas vitit 1980, afrimi per tek kullotat i'u la ne dore sistemit kombetar per caktimin e vendburimeve per kooperativat dhe fermat shteterore.

Para vitit 1983, kullotat e kolektivizuara u administruan nga Drejtoria e pyjeve. Ne vitin 1983 u krijua Drejtoria e kullotave per hapjen e kullotave te reja, per te ndihmuar nje drejtim me intensiv te kullotave si dhe ne mbledhjen e qirave qe kishin te benin me keto kullota. Me prishjen e kooperativave duket se Ndermarrja e kullotave do te hyje ne marreveshje me keshillat e fshatrave per kthimin e ketyre kullotave nen administrimin e ketyre keshillave.

Rasti i drejtimit te kullotave ne rrethin e Korces eshte me rendesi lidhur me faktin se si jane drejtuar pyjet deri ne momentin e tanishem. Ndermarrja shteterore dhe ajo e kullotave administron rreth 30.000 ha kullota ne rrethin e Korces dhe Pogradecit. Keto jane kryesisht kullota verore te nje lartesie mbi 1.000 m. Disa jane afer fshatrave dhe mund te shfrytezohen vetem gjate muajve te veres. Gjate muajve te dimrit, gjedhet mbahen ne stalla ose dergohen ne jug te vendit (jo me shume se sa 10.000 koke bageti -dergohen cdo vit ne jug te vendit). Nga 200.000 koke dhi dhe dhen, tashma 90% te tyre jane te privatizuara. Nodohen gjithashtu rreth 50.000 koke lope ose qe. Dhjete dhen dhe dhi jane baraz me nje lope persa i perket sasise se qumeshtit qe merret prej tyre. Rrethi ka patur rreth 15.000 ha te mbjelle me foragjere per ushqimin e gjedheve, ku nuk ka patur toke kullotore, c'ka perben rreth 0,3 ha per cdo gjedh.

Ndermarrja kullotore i ndan kullotat ne zona per afersisht 5.000 ha dhe ku secila prej tyre drejtohet nga ana e nje agronomi ose inxhinieri pyjesh. Detyrat e drejtuesit te kullotave perfshijne pastrimin e kullotave nga guret, shkuljen e barerave te keqija, perdorimi i kimikateve dhe, mbi te gjitha, ndertimin dhe mbajtjen e burimeve te ujit.

Para ckolektivizimit te bujqesise, fermat shteterore dhe kooperativat paguanin 9 lek per cdo bageti per te kullotur ne kullota per nje periudhe prej pese muajsh. Kete vit fermave shteterore dhe pronareve individe i kerkohet 30 lek per cdo koke bageti dhe 70 lek per cdo gjedh. Qellimi eshte qe kjo sasi te hollash te mblidhet ne muajin qershor. Pronaret e bagetive jane pergjegjes per te treguar kujdes per to gjate kohes ne kullota. Me prishjen e kooperativave, pronaret e bagetive te fshatrave duhet te bashkohen per te gjetur cobane dhe per te marre masa per pagimin dhe mbikqyrjen e tyre. Eshte e mundeshme qe pronaret individe te gjejne dike per t'u kujdesur per bagetite e tyre edhe pse shperndarja e gjese se gjalle ne keta dy vitet e shkuar eshte bere ne 25.000 fshatare te rrethit.

Kullotat e nje kooperative bujqesore qe me pare ishin caktuar per perdorim per kater ose pese fshatra, tani jane ndare midis fshatareve perberes. Keto kullota konsiderohen akoma prone e shtetit dhe shteti po punon qe fshatrat te perdorin kullota te tilla. Duket se rregulli i pergjithshem eshte vetem per kullota te vecanta per tu perdorur vetem prej fshatareve te nje fshati te caktuar.

Para kolektivizimit te tokes, kullotat e ndodhur afer fshatrave u konsideruan prone e perbashket e fshatit, ne kuptimin qe fshataret qe kishin bageti mund ti kullotnin ato pa paguar asnje te holle. Kishte gjithashtu edhe pronare individe, te cilet kishin pjesen e tyre ne keto kullota. Gjedhet prone e ketyre pronareve private dergoheshin ne rreth, afersisht 200.000 koke, per te perfituar nga temperaturat e ftohta dhe kullotat burimore ne Korce. Shteti ishte pronar i kullotave malore dhe zbatonte te njejtat rregulla qiraje, ne nje fare menyre njelloj me sistemin e tanishem.

Gjate pak dekadave te shkuara, kullotat e mira u kthyen ne toka buke ne menyre qe cdo fshat te vetsiguronte buken. Zvogelimi i tokave kullotore rezultoi jo vetem cuarjen ne mungesea ushqimore, por gjithashtu edhe ne perdorimin e tokave te brishta te papershtateshme per toka buke dhe kullota duke kaluar ne erozion. Me kthimin e tokave kullotore ne toka

buke, tani eshte arritur ne jo me shume se sa 30.000 koke bageti e imet dhe numri i tyre ne rreth eshte pak me i larte se sa ai qe ka qene ne vitin 1938. Duket se numri i bagetise se imet eshte rritur pas shperndarjes se tokes dhe prishjes se kooperativave.

Ushqimi i gjese se gjalle ka pase qene problem ne keto vitet e fundit. Para ckolektivizimit, nje vic dy vjecar peshonte mesatarisht 325 kg po te rritej nga fernmat shteterore dhe 275 kg po te rritej nga kooperativat. Cmimi relativ i nje bagetie ka qene i ulet. Cmimi i shitjes te nje kg mishi bagetie ka qene baraz me tre kg grure. Edhe tashma, cmimet e mishit jane jo stabel, por duket se cmimi i mishit te gjese se gjalle eshte rritur.

Ckolektivizimi i gjedheve ndodhi para shperndarjes se tokes. Sistemi i trasheguar ishte qe bagetite e kooperativave te ndaheshin ne menyre te barabarte midis fshatareve perberes. Mandej behej vleresimi i bagetise se fshatit dhe fshataret kontribonin qe vlere per kapital e gjese se gjalle ti kalonte fondit te gjese se gjalle te fshatit. Ata qe deshironin te merrnin bageti mund ta benin nje gje te tille, ndersa ata qe nuk deshironin i ndanin te ardhurat e perbashketa midis tyre. Keshillat e fshatrave caktonin cmimet e bagetive dhe benin shperndarjen e tyre.

Administrimi i kullotave duket se po behet ne menyre te crregullt, nga ku de fakto drejtimi po i kalon pronareve individe te bagetive ose grupeve te pronareve individe. Per kete kohe, rreziku real i pushtetit te dobet dhe atij te drejtimit jo efektiv nga ana e shtetit ka te beje me mos ekzistencen e nje bashkepunimi te mjaftueshem midis pronareve te bagetive per te shmangur degradimin e kullotave.

Procesi i decentralizimit mund te jete pozitiv poqese nuk behen rregullime institucionale per te zevendesuar ato te zoteruara nga shteti dhe ato te drejtimit te kullotave. Tashma duhen vene ne testim opsione te reja juridike, polititke dhe organizative. Me konkretisht:

- Jetgjatesia e dhenieve te qirave afatgjata ose pronesimit te plote te disa kullotave nga ana e individeve private per te pare nese mbajtesit private te kullotave ne kushtet e cmimeve te permiresuara per gjedhet, do te cojne ne berje investimesh per permiresimin e tokes dhe sistemeve me intesive te rritjes se gjese se gjalle duke ulur keshtu presionet

ndaj pyjeve dhe perdorimit te tokes pyjore per kullota.

- Pronesim (ose dheniet me qira afatgjata) te kullotave nga ana e keshillave te fshatit ose shoqatave jo qeveritare te rrethit dhe ato rajonale dhe drejtimit te kullotave te tilla per te plotesuar nevojat e pronareve te bagetive.

Per kryerjen e ketyre testimeve duhen inkurajuar iniciativat e fshatareve dhe kuadri juridik i adaptuar per te lejuar forma te ndryshme te ruajtjes se tokes. Hedhja ne harte e parcelave te kullotave dhe ndarja e kufijve te tyre ne toke jane te nje rendesie te madhe.

11. PRISHJA E FERMAVE SHTETERORE

Ne ekonomite e komanduara dhe modeluara nga ish BS sic mund te thuhet per Shqiperine e pas luftes se dyte boterore, fermat shteterore u krijuan per te siguruar prodhime bujqesore per qytetet dhe grupet e njerezve te veshur me pushtet. Per rrjedhim, fermat shteterore u siguruan me burime te pasura, me pajisje te rendesishme importi te blera me valute, makinerira, teknologji, specialiste etj, gje qe nuk i jepeshin pjeses tjeter te bujqesise, d.m.th sektorit kooperativist. Punetoret e fermave shteterore merrnin page te rregullt dhe perfitime te tjera njelloj si edhe punetoret e ndermarrjeve te tjera shteterore. Krejt ndryshe, fshataret qe punonin ne kooperativa merrnin nje vlere te prodhimeve te tyre me cmime shume te ulta te caktuara nga agjentet bleres shteterore, pasi paguhej nje kosto e larte e imponuar nga shteti per prodhime te prodhuara ne vend. Per me teper, fermat shteterore ne Shqiperi dukeshin sikur ishin krijuar kryesisht ne tokat e ish pronareve te medhenj te tokave ose ne tokat e reja te hapura nga punetoret e ndertimit te shtetit, nga ata qe merreshin me tharjen e kenetave ose cpyllezimin e aneve te kodrave.

Qysh prej vitit 1991, qeveria e re ka filluar me shpejtesi privatizimin e sektorit kooperativist dhe ndarjen e tokes per cdo pjestar te fshatit. Deri ne qershor 1992, sektori i fermave shteterore, qe kapte 23% te tokes se punueshme, me shume se _ e popullsisë se fermave dhe shumica e investimeve kapital ne bujqesi, qendroi jashte procesit te rindertimit.

Reforma eshte plotesisht e nevojshme; vleresohet se vitin e shkuar fermat shteterore kane humbur 3 miliard lek.

Reforma e tokes e fermave shteterore u vonua per shkak te mosvullnetit te qeverise per t'u marre me reformen e sektoreve kooperativist dhe fermave shteterore ne te njejten kohe, dhe per arsye se problemi u pa teper i ngaterruar.

Se pari, shume zyrtare te specializuar ne fushen e bujqesise pyesin nese mund te privatizohen fermat shteterore, apo jo. Keta specialiste besojne se fermat ishin shume produktive deri ne vitin 1978, kur shkeputja nga Kina i kushtoi Shqiperise shkembimin ne valute qe asaj i nevojiteshin per te blere prodhime te tilla si (ushqime te pasuruara per bagetine, traktore), te cilat i mbanin fermat shteterore ne gjendje prodhimi. Po ashtu, ata besojne se me valuten e siguruar nga investoret e huaj dhe me futjen e teknikes perendimore, fermat shteterore mund te behen perseri eficiente dhe prodhuese te nje shkalle te gjere. Pervec kesaj, porsa fermat shteterore te prodhojne per c'ka mund t'i paguaje tregu boteror, ne vend te asaj qe deshiron te konsumoje nje elite parazitare e nje ekonomie te komanduar, mandej mund te diskutohet per perfitimet e medha te nxjerra prej tyre. Shkurtimisht, drejtoret e fermave shteterore, specialistet parlamentare te bujqesise dhe disa zyrtare te Ministrise se Bujqesise jane kunder privatizimit te fermave shteterore duke besuar se kjo mund t'i kushtoje shume Shqiperise dhe te humbase nje burim teper prodhimitar e me shume te leverdisshem. Ata do te proferonin t'i kthenin fermat shteterore ne ekuivalente te firmave me kapital te perbashket te mbeshtetura prej financimit te huaj, me tregje te siguruara nga nje investor i huaj.

Vezhgimet e bera ne Shqiperi zbulojne se ky skenar mbeshtetet mbi premtime te gabuara. Se pari, ne kemi shume dyshim nese fermat shteterore ishin me perfitim, apo jo deri ne vitin 1978. Ne fakt, fermat shteterore prodhonin duke u bazuar ne prodhime te marra diku tjeter ne menyre artificiale dhe duke imponuar cmime te ulta. Ceshtja e perfitimit ne raste te tilla mund te jete arritur, por bazuar ne eksperience diku tjeter dhe as mund te mendohet qe ky sistem te kete qene ndonjehere i perfitueshem sipas standarteve te ekonomise se tregut.

Se dyti, nuk eshte e vertete se fermat shteterore ndodhen mbi toka qe nuk kane qene ne te vertete toke private. Ne fakt, pothuaj te gjitha fermat shteterore inkorporonin disa fshatare, te cilet theksonin se kane pase qene te shpronesuar.

Per me teper, nje pjese e kesaj toke te re te supozuar vene nen kultivim nga fermat shteterore perben token qellimi i se ciles u ndryshua nga ajo e nje perdorimi racional ekonomik dhe ekologjik drejt asaj te nje perdorimi aspak racional dhe ekonomik, njelloj sikur te flasim per kodrat e perdorura per kullote dhe qe u kthyen ne kodra te tarracuara dhe qe gradualisht i'u nenshtruan erozionit, ndersa gjeja e gjalle u ushqye me prodhime te kushtueshme importi.

Se fundi, numri i madh i punetoreve te fermave shteterore, te cilet banojne ne fshatrat fqinje ose qytete dhe ata te paket ne numer qe erdhen prej rajoneve malore te varfera veshtrohen nga fshataret si te huaj dhe qe u eshte dhene pasuri nga ajo qe u perkiste fshatareve teper punetore lokale dhe jo grave duar buta te qyteteve apo atyre te ardhur nga rajonet malore. Po t'iu lihet atyre ne dore, ata do t'i detyrojne me force te lartpermendurit qe te largohen nga toka qe kane dhe t'ia kthejne token perdorimeve te detyruara nga ekonomia e tregut. Sa me shume te kaloje koha e nje privatizimi te tille qe te mos behet, aq me te medhaja kane per te qene tensionet ndaj fermave shteterore midis fshatareve dhe gjithe te tjereve, problem ky shume i madh.

Ne rast se merret nje mundim per te zgjatur jeten e fermave shteterore, ata do te gjejne nje menyre me te privilegjuar ndaj mallrave qe gradualisht po ju rreshqasin nga duart, nga qe cdo dite e me teper mallra te tilla po shperndahen nga ana e tregut. Ne nje periudhe te tille pasigurie te perkoheshme, punetoret e egersuar dhe te shqetesuar angazhohen ne procese me te ngadaleshme, shkaterrojne fermat shteterore, shesin ose vjedhin mallrat shteterore duke e bere me te qarte zemerimin e tyre.

Nje aresye tjeter qe udheheqesit politike e kane vonuar privatizimin duke kerkuar alternativa te tjera perben nje ndergjegjesim se toka dhe ritmi i popullsise eshte aq i ulet ne fermat shteterore sa qe ndarja per cdo fryme te popullates do te krijonte probleme te shumta ne krijimin e nje bujqesie te orientuar dhe qe kerkon mbeshtetje te madhe. Poqese toka do t'iu kthehej fshatareve lokale, kjo do te conte ne largimin e _ te punetoreve te fermave shteterore prej tokave te tyre duke rritur keshtu problemet tashma te lindura te papunesise, krimi, largimit per ne qytete dhe krijimit te nje barre te madhe mireqenieje.

Keto jane shqetesime serioze. Pothuaj asnje ferme shteterore nuk do te dale me perfitime dhe te jete terheqese per investoret e huaj poqese se forca e saj punetore nuk ulet ne

rreth _ dhe poqese nuk qartesohej struktura e pronesisë ndaj pasurisë. Kjo do të thotë se punësimi jashtë fermës duhet të rritet në mënyrë të shpejtë duke vënë në zbatim projekte pune infrastrukturore, siç mund të flitet për krijimin e fermave në përshtatje me ekonominë e tregut. Megjithatë, masa të shumta të perkoheshme ndihmojnë në një periudhë tranzicioni dhe zgjidhja e vertetë kërkon futjen në punë të njerezve jashtë fermave. Në Kinë, reforma e kolektivizimit u shoqërua me zbatimin e një programi industrializimi rural, i cili thithi një numër të madh njerezish jashtë sektorit bujqësor, si në fshatra dhe qytete provinciale dhe qendra të tjera të vogla qytetare. Qeveria mund ta shpejtojë këtë proces me anë të pronesisë së decentralizuar dhe duke bërë privatizimin e ndërmarrjeve me shperblime për me shumë investime lokale.

Është me rëndësi të hiqet dorë prej iluzionit se fermat shtetërore kanë pasë qene fitimpruresë me parë dhe se po të perdoren traktore të rinj e të mëdhenj, ato mund të kthehen perseri në fitimpruresë. Traktoret u keqperdoren dhe u shkaterruan për mungesë pjesësh këmbimi, si dhe për mos mbajtje të rregullt të tyre. Tendencat e ekonomisë së tregut kërkojnë mjete më të vogla dhe më intensive. Dhuruesit dhe Ministria e Bujqësisë dhe ajo Ushqimore kanë nevojë që të permiresojnë përdorimin prodhues të mjeteve të tilla në ish sektorin e fermave shtetërore dhe në ish sektorin e kooperativave bujqësore duke përgatitur teknike shërbimi, të permiresojnë rregullat e dhenies me qira të makinerive, të hyjnë në lidhje me persona që shesin pjesë ndërrimi në vendet fqinje dhe të organizojnë fermeret lokale në shoqata private fermeresh për marrje kredish dhe rregullim të shitjeve, blerjeve, eksporteve e kështu me radhë.

Perpjekjet e bera artificialisht për të ruajtur prodhimin shtetëror nuk janë vecsë perpjekje për të perseritur paarsyeshmerinë jo ekonomike dhe shkatërrimtare të epokës së mëparëshme të një ekonomie parademokratike komanduese. Të ruash mbajtjen e fermave shtetërore në formën e kompanive të përbashketa mund të jete në përfitim të zyrtareve, të drejtoreve të fermave shtetërore dhe forcsë punetore ekzistuese. Një shkaperdredhje e tillë do të demtojë ekonominë dhe rrisë zëmerimin dhe varesinë që mund të shkohet lehtësisht drejt një qëndrimi antidemokratik.

Familjet e ish-pronareve, pa dyshim do të ndjehen të tradhetuara poqese nuk kompensohen. Ato ishin viktimat e para të rendit komunist dhe tani kanë frikë se qeveria demokratike do të reagojë me premtime elektorale për kompensim të tyre. Qeveria nuk ka as të holla dhe as toke për të kompensuar ish

pronaret dhe gjithë pretendet e tjere. Zyrtaret, të cilët i llogarisin këto familje rreth 20.000 individë, me shumë ose me pak, në fakt nënvlefësojnë influencën politike të këtyre pretenduesve. Ata duhen trajtuar në mënyrë të ndërshtme. Një opsion për shtetin është që t'iu ofrojnë këtyre familjeve si kompensim artikuj industrialë, të cilët mund të përdoren për të siguruar kredi prej Bankës së Bujqësisë dhe asaj të Zhvillimit bazuar në provën se një ndërmarrje mund të dalë me fitim duke bërë punësimin e punonjësve jashtë ferme apo në rajone të tjera të vecanta.

Shkurtimisht, qeveria po kërkon rrugë për të rritur në maksimum ekuitetin, punësimin dhe efikasitetin duke krijuar njësi dhe organe ekonomike që do provojnë veten si të përfitueshme e tërheqëse për investitorët e huaj, një detyrë kjo shumë e vështirë për një periudhë të tillë në krizë ekonomike dhe politike. Ky sektor duhet të ripajiset me kapital të ri dhe kjo vështirësi realizohet pa bërë privatizimin e plote, me anë të të cilit në kemi ndërmend dhenien fund të pronesisë shtetërore mbi tokën dhe ndërmarrjet si dhe tërheqjes së shtetit prej rolit të tij drejtues. Brenda këtyre parametrave ka mundësi për të bërë eksperimente dhe Shqipëria duhet ta bëjë një gjë të tillë nëpërmjet skenarëve të ndryshëm të privatizimit të fermave të ndryshme shtetërore. Prishja dhe shpërndarja e tokës mund të jetë me vend në disa raste. Kur mjetet e përpunimit kanë lidhje me fermat shtetërore, ato duhen privatizuar vecmas dhe të hyhet në kontrata prodhuese me fermerët e rinj, ose ndryshe fermat të privatizohen si njësi të mëdha. Ekzistojnë organizime të shumëllojta të mundshme midis investoreve të huaj dhe atyre që kanë interesa lokale. Ekziston një ndërgjegjësim për gjithë këto opsione në Ministrinë e Bujqësisë, por asnjë nuk duhet marrë si model. Zgjidhjet kanë nevojë për t'u imponuar sipas rrethanave të vecanta të fermave shtetërore specifike.

12. CESHTJE QË KANË LIDHJE ME KREDITË

Banka e Bujqësisë dhe ajo e Zhvillimit u krijuan në vitin 1991 për të lehtësuar privatizimin. Banka drejtohet me lehtësi dhe po krijon një shtab profesional kompetent. Urdhëresat e organeve lokale janë që banka të bëhet autonome, d.m.th, të veprojë sipas kriterëve të ekonomisë së tregut dhe të mos detyrohet t'i përgjigjet presioneve politike afat shkurtëra.

Megjithate, deri tani, Banka ka qene e detyruar t'i pergjigjet presioneve politike afat shkurtera per te plotesuar nevojat me te nguteshme te fermereve me te varfer ne rajonet me te varfera, dhe nevojave te eksportit te bleresve italianë te drithrave. Ne rast se marresit e kredive ne Banke do te kene leverdi, ata qe jane ne gjendje do te varferohen poqese do te furnizohen me burime plotesuese prej shtetit ose ne rast se do te mbeshteten nga nje rrjet social i besueshem.

Ne rast se banka udhezohet qe te filloje nga dhenia e kredive per ish fermat shteterore, kjo ka per ta intesifikuar krizen bankare dhe ate te kreditit me nje humbje vjetore 3 miliard leke, pothuaj 10 here ne krahasim me fondin origjinal te bankes.

Banka do te beje punen e saj poqese nje sistem pasurie i institucionalizuar lejon token per ta mbuluar borxhin. Kjo kerkon ligje dhe institucione te reja dhe nje kapacitet per te vepruar si banke. Qellimi do te jete profesional, jo korruptues, sistem decentralizues per dhenie huaje baze kritereve bankare. Krediti i saj kerkohet mjaft dhe duhet t'iu jepet atyre qe mund te rrisin ne maksimum perdorimin e saj prodhues. Ndryshe, shumica e kredive duket se ka qellim te ndaloje rastin me te keq, arritjet politike afat shkurtera. Eshte me rendesi qe ne te ardhmen krediti te shperndahet ne nje menyre te drejte, qe si burrat dhe grate te kene te drejte te marrin hua per artikuj bujqesore.

13. PERSPEKTIVAT DHE REKOMANDIMET

PERSPEKTIVAT

Reforma e tokes ne Shqiperi te ben shume pershtypje ne dy konceptime: ne kalimin e saj radikal per te arritur ne pronesim te plote privat te tokes dhe zbatimit te saj, e cila ne sektorin kooperativist eshte bere shume shpejt.

Ajo eshte premtuese edhe po te merret baze prodhimi. Ajo c'ka eshte kryer deri tani ka pase te bente me ndryshimin e struktures agrare te shumices se fermave shqiptare perez kooperativave drejt ekonomise familjare. Reforma paralele e bere ne Kine pas vitit 1978 ka patur shume rezultate pozitive ne prodhim, edhe pa kaluar ne te drejta te plota te pasurise. Prodhimi bujqesor u rrit ne 61% midis vitit 1978 dhe 1984.

Disa vleresime flasin se _ e kesaj rritjeje i atribohet reformes se tokes. Ne fakt, ne retrospekt, nuk eshte e mundur qe te vecosh plot besim influencen e reformes se tokes dhe, nga ana tjetere, liberalizimin e njekohshem te cmimeve bujqesore. Pranohet gjeresisht se reforma do te coje pa tjetere ne rritje te prodhimit.

Ne Shqiperi nuk duhet parashikuar ndonje gje shume dramatike. Ne krahasim me Kinen ku kalimi u realizua ne nje mjedis pak a shume stabel politik dhe ekonomik, ne Shqiperi ndryshimi rrenjesor dhe konfuzioni ka prekur edhe sektore te tjere ekonomike. Kjo eshte vecanerisht kritike persa i takon furnizimeve brenda vendit dhe marketingut. Në Amerikën Latine, reformat e tokes te nje karakteri klasik, toka t'i jepet atij qe e punon, u shoqerua me nje renie te madhe te prodhimit. Pronaret e tokave kishin luajtur nje rol te rendesishem ne furnizimet brenda vendit dhe me marketimin e qiramarresve te tyre, rol ky rendesia e te cilit kishte qene nenvleresuar ne piken kulminante politike te reformes dhe mori kohe per te krijuar kanale alternative. AID po perqendrohet ne furnizimin me plehra kimike, proces ky qe drejtohet direkt nga shoqata private e fermerëve dhe poqese dalin me sukses, kjo ndihmon shqiptaret qe te marrin perfitimet e reformes se tyre te tokes.

Ka gjithashtu tregues se ekzistojne fitime te kapshme potenciale ne prodhimtarine qe mund te merret duke siguruar te drejta te plota pasurie dhe nje sistem te dhenash pasurie, i cili lehteson proven e te drejtave si dhe siguron ruajtjen dhe sigurine ne keto kalime tranzicioni. Siguri me e madhe ruajtje e tokes shpresohet se do te kete influence pozitive ne te dy llojet e investimeve, atij te drejtperdrejte dhe atij nepermjet dhenies se kredive. Ne Tailande, studimet e bera nga fondet e Bankes boterore ne projektin e regjistrimit te tokes ne fillim te viteve 80-te cuan ne rritje te madhe te prodhimit gjate disa viteve te ketij programi, kryesisht nepermjet formave te permiresimit te kreditit te sektorit zyrtar siguruar nga ana e nje personi me te drejte dhenie te hipotekimit.

Perseri, keta jane skenare te "rasteve me te mira". Prodhimtaria arrihet si rezultat i nje reforme te zoterimit te tokes dhe rregjistrimi i tokes do te varet kryesisht ne kushtet e nje ekonomie tregu. Per shembull, titullimi pati pak efekt ne fushen e prodhimit ne rajone te ndryshme ne Tailande, ku nje kredit i bollshem i sektorit jo zyrtar ishte i pranishem per fermeret pa rekurs drejt sigurimit te tokes.

Sugjerimi ketu nuk ka te beje me ate se perfitimet ne prodhim mund te arrihen menjehere. Fakti eshte se edhe ne situaten me te veshtire dhe konfuze te bujqesise ne Shqiperi sot, vetem reformat mund te bejne te mundur arrijten e nje prodhimi stabel per dekadën e ardhshme. Per realizimin e tyre nevojiten ligje per ceshtjen e pasurise, te cilat sigurojne rregullime te shumeaneshme e te sigurta te tokes; kerkohet te fillohet edhe me nje sistem te dhenash te pasurise, i cili do siguroje perfitime per fermeret dhe po ashtu te zhvillohet prodhimi i brendshem, krediti dhe lehtesimet e marketimit.

PROBLEME DHE REKOMANDIME

Trajtimi i shperndarjeve të crregullta: Ne disa fshatra jane bere shperndarje jo ne perputhje me bazat per fryme te mandatuara me ligje. Duhet bere cdo lloj perpjekje per zbatim te ligjit. Por edhe atje ku ndarja e tokes eshte realizuar si rezultat i perkrahjes se gjere si fshat, jo gjithcka ka ecur me lehtesi. Ne veri te vendit, ne degjuam diskutime per perdorim force nga ana e qeverise per te realizuar ndarjen e tokes ne keto fshatra. Pervec krijimit te pronave te reja, ekziston edhe nje interes i madh social per ruajtjen e stabilizimin e ketyre pronave. Duhet shmangur rishperndarja ne shkalle te gjere. Poqese dikush shikon se nuk eshte zbatuar ligji, zgjidhja do te jete qe te zbatohen vendimet e gjykates lidhur me kompensimin kunder atyre ne fshat, te cilet kane pase perfituar nga nje gje e tille. Mund te jete e nevojeshme qe te behen edhe rirregullime per rastet kur dikujt i eshte caktuar dhenie toke dhe eshte perjashtuar plotesisht nga nje proces i tille. Por eshte me rendesi se keto nevoja nuk duhet t'i japin nje kohe te gjate komisioneve te tokave per te vepruar. Ato duheshin bere dhe duhen bere perkohesisht.

Ne rekomandojme qe pas perafersisht gjashte muajsh, te nxirret nje ligj, i cili: (1) ti jape fund autoritetit te komisioneve te tokave; (2) te siguroje qe te gjitha pretendimet ndaj vendimeve te marra nga komisionet e tokave, ne te ardhmen te behen nga ana e gjykates; (3) te vendosë kritere për gjykatat per te marre vendime ndaj ketyre pretendimeve dhe të përcaktohen edhe masat juridike që duhen zbatuar; (4) te shpalle se gjithë keto pretendime duhen shqyrtuar brenda nje viti qe nga koha e daljes se ligjit, ose ndryshe ato behen te pavlefshme.

Kompensimi: Qeveria ka shpallur qellimin e saj per t'u marre me ceshtje historike jo nepermjet kthimit te tokes, por

nepermjet kompensimit. Nje rruge e tille duket e drejte sepse ajo minimizon dispozimin e atyre qe e kane perdorur token dhe keshtu anekson dislokimin e prodhimit. Megjithate, ajo nuk mund te shmange veshtiresine per te vendosur se cilet pronare "origjinale" duhen kompensuar, ata para apo pas shperndarjes se tokave ne vitin 1945. Kompensimet e vleresuara ne mungese te nje tregu per token jane te veshtira, por ne raste te tjera situatash te reformes se tokes ku vleresimet e tregut nuk mund te beheshin, jane perdorur forma te shumefishimit te vleres se prodhimit vjetor midis 10 dhe 16, qe sipas te dhenash empirike do te jete pak a shume vlere e tregut te tokes ne nje shtete te caktuar tregu toke.

Ne rekomandojme qe kompensimi te behet bazuar ne pronat e para vitit 1945 dhe te behet bazuar ne disa shumefishime te caktuara te karakterit lokal te vleres se prodhimit aktual vjetor.

Ne rekomandojme qe kompensimi, fillimisht te jepet ne formen e artikujve industriale nga ana e qeverise dhe duke patur interesa ne ndermarrjet shteterore industriale te cilat jane privatizuar.

Ne shenojme se asistenca e dhene nga donore per kompensime te tilla nuk shkon aspak, vecanrisht ne rastin e SHBA, ku ligji (Amandamenti Helms i Aktit te Ndhimes se huaj) ndalon perdorimin e asistences se huaj per qellime te tilla.

Nje reforme toke: Kryerja e reformes se tokes eshte e nje rendesie te madhe per kapitalizimin e sektorit te bujqesise. Nje reforme toke ka si qellim qe te coje drejt efikasitetit ne shperndarjen e tokes dhe eshte nje kusht i nevojshem per perdorimin e tokes si kolaterale per marrje huaje. Nga ana tjeter, ne kete moment tranzicioni, tregjet jane teper te crregullt saqe mund te krijone lehtesisht perfundime te paparashikuara. Qeveria, ne menyre te kuptueshme, i friksohet spekulimit me token dhe ngeljes se familjeve pa toke. Ka arsye per te patur frike prej shitjeve te tokes nga kryetaret e familjeve duke i lene familjet te varfera.

Ne rekomandojme qe fillimisht qeveria duhet te lehtesoje operacionin e reformes rentaleduke vezhguar edhe veshtiresite qe do te lindin. Ne nje date te mevoneshme, brenda fshatit, ajo duhet te lejoje edhe shitje lokale. Keshtu pas pese vitesh do te lejohet nje reforme e pakufizuar gjeografikisht dhe e plote.

Ne rekomandojme qe shitjet te mos lejohen deri sa te kete nje strategji te qarte dhe nje baze juridike per mbrojtjen e interesave te gjithe anetareve te familjeve

perfshi edhe grate ne token e marre prone, duke kerkuar pelqimin e tyre per cdo lloj shitjeje dhe duke i dhene atyre te drejten per cdo cope toke te cdo cmim për çdo çmim shitjeje.

Grate dhe toka: Statuti juridik i grave pronare te tokave eshte i paqarte dhe ka nevojte te kualifikohet dhe qartesoht. Duhet percaktuar edhe nene per të inkurajuar fshatrat të marrin ato funksione qe me pare kryheshin nga kooperativat, për vazhdimin e shërbimeve për gratë, të përkrahura nga komunat, sic mund te përmendim qendrat e kujdesit për fëmijët dhe lavanterite. Eshtë e nevojshme te behen studime kërkimore per dallimet veri-jug, dhe midis zonave urbane dhe rurale per rolin e grave si punetore dhe pronare dhe si influencon kjo ndaj nje reforme efektive të tokës, e keshtu mund të përcaktohen masa të efektshme juridike per mbrojtjen e te drejtave te pasurise se grave.

Pyjet dhe kullotat: Ne projektet legjislativne ne pergatitje gjate vizites sone ne Shqiperi, pyjet dhe kullotat jane mbajtur si toke shteterore. Si rregull i pergjithshem, kjo mund te jete e pershtatshme. Por ka shume fshatra, vecanerisht ne veri te vendit, vlershmeria ekonomike e te cilave kerkon mundësi hyrjeje per tek vendburime me te medha natyrore. Kjo mund të çojë në daljen e drejtuesve me te mire te kullotave dhe pyjeve po te bashkohen me komunat e tyre dhe po qe atyre u jepet nje status më i sigurtë.

Ne rekomandojme qe te bëhen nene per dhenien me qira te rajoneve pyjore, të privatizohen ndermarrjet për të siguruar nje prodhim me te qendrueshem dhe dhenies me qira te rajoneve me bime te shumellojta - organizatave jo qeveritare per ruajtje.

Ne rekomandojme gjithashtu qe te dalin nene juridike per kalimin e rajoneve te pyjeve dhe kullotave nga pronesia e shtetit ne pronesi te fshatrave lokale, ku nga ana e komunes eshte pergatitur edhe nje skeme e besueshme drejtimi e pasurisë së përbashkët.

Prishja e fermave shteterore: Nuk do të ishte e drejtë qe te pershkruhet ndonje model standart per prishjen e fermave shteterore. Nuk kërkohet vetëm çpronësim i tokës, por edhe i të gjithë kompleksit ekzistues, i ndermarrjes shfrytëzuese. Ne disa raste, toka mund te ndahet pjeserisht ose teresisht; ne raste te tjera, mund te mbahet edhe gjendja aktuale. Përdorimi i rrugëve te ndryshme do të ishte i pashmangshëm. Megjithatë, ne rast se kerkohet te arrihet qëndrueshmëri ekonomike, të gjithë do të kërkojnë shpërbërjen e një pjese të madhe të forcës punetore te fermes shteterore. Politikisht,

shteti do ta kete te veshtire per te marre vendime e duhura për drejtimin.

Ne rekomandojme se sido qe te jete mekanizmi, duhet kaluar në shperberje dhe privatizim të vërtetë. Kjo nuk do te thote qe shteti nuk do te mund te ruaje disa interesa si pjesëtar ne ndermarrjen e privatizuar, por po te ndodhe kjo, ai do te kete vetem nje pjese te vogel dhe asnje rol te vecante në drejtim.

Sistemi i regjistrimit te pasurise: Shqiperia ka nje model te ri persa i perket pronesise mbi token, me tituj te pakropomentuar nga ana e gjeneratave te transaksioneve të pakuptueshme dhe trashegimnive te ngaterruara. Ekziston nje rast i veçantë per te ruajtur thjeshtesine dhe sigurine e titujve te rinj duke krijuar nje sistem regjistrimi te pasurise. Nje sistem efektiv i tille pasurie eshte i nevojshem per arritje rezultatesh inkurajuese te pasurise private dhe te reformes se tokes.

Ne rekomandojme qe qeveria te ngreje nje komision per te vendosur per llojin e sistemit dhe si duhet te funksionoje nje sistem i tille, dhe keshtu nje ose dy donore mund te ndermarrin hapat e nevojshme per te informuar per punen e komisionit dhe t